

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
PM nr. 01/2016
18 prill 2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS – trupi gjykues për të mitur - i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira de Madureira si kryetar i trupit gjykues të EULEX-it për të mitur, Kimete Fejza gjyqtare laike dhe Novak Mirkoviq gjyqtar laik, në cilësinë e anëtareve të trupit gjykues, me ndihmën e zyrtares ligjor Vera Manuello, si procesmbajtëse, në lëndën për të mitur kundër:

A. P., emri i babës, B_____, i nënës, S_____, i vajzërisë S_____, i lindur me _____.____ në _____ - shqiptar i Kosovës, me banim në _____ – rruga ____ nr __, Komuna e _____ nr. i letërnjoftimit nuk dihet, i pamartuar, profesioni: i papunë, ka të kryer shkollën fillore, ka qenë në paraburgim nga 25 qershori 2015 deri me 10 gusht 2015;

A. S., emri i babës, X_____, i nënës, A_____, i vajzërisë B_____, i lindur me _____.____ në _____ të _____, shqiptar i Kosovës, me banim në rruga _____ nr __ – kati __, Komuna e _____, nr. i letërnjoftimit nuk dihet, i pamartuar, me profesion: nxënës i shkollës së mesme (viti i parë);

V. B., emri i babës, E_____, i nënës, V_____, i vajzërisë F_____, i lindur me _____.____ në _____, shqiptar i Kosovës, me banim në Rruga _____ nr. __, Komuna e _____. Nr. i letërnjoftimit nuk dihet, i pamartuar, me profesion: nxënës i shkollës së mesme (viti i parë);

M. D., emri i babës, B.1._____, i nënës, S.2._____, i vajzërisë K_____, i lindur me _____.____ në _____ – _____, shqiptar i Kosovës, me banim në _____ nr. i letërnjoftimit, nuk dihet;

B. S., emri i babës, M_____, i nënës, F.1._____, i vajzërisë K.1._____, i lindur me _____.____ në _____, shqiptar i Kosovës, me banim në _____ – _____, nr. i letërnjoftimit, nuk dihet; dhe

E. R., emri i babës, S.3._____, i nënës, A_____, i vajzërisë N_____, i lindur me _____.____ në _____, shqiptar i Kosovës, me banim në _____ – rruga _____ nr __, nr. i letërnjoftimit, nuk dihet;

të cilët akuzohen me:

Akuza I

A.P. _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **E.R.** _____:
Vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 179, nën-paragrafi (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPRK;

Akuza II

V.B. _____, **M.D.** _____ dhe **A.S.** _____:
2) Kërcënim në kundërshtim me nenin 185, para (1) dhe (4) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

V.B. _____:
3) Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374, para (1) të KPRK-së;

Akuza III

A.P. _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **B.S.** _____:
4) Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në kundërshtim me nenin 147, para (1) dhe (3) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
5) Kanosja në kundërshtim me nenin 185, para (1) dhe (4) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
6) Vjedhje në kundërshtim të nenit 325 para (2) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

V.B. _____ dhe **A.P.** _____:
7) Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374, para (1) të KPRK-së;

Akuza IV

A.P. _____:
8) Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në kundërshtim me nenin 147, para (1) dhe (3) të KPRK-së.

Në bazë të nenit 73 para (3) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM),

Lëshon këtë:

AKTVENDIM

I. Masat

1. Për të miturin A.P. _____ Gjykata shqipton masën edukative institucionale dhe dërgimin e tij në një institucion edukativo-korrektues **për 2 (dy) vite**, në bazë të nenit 20 para (4) dhe nenin 28 të KDM-së;

2. Për të miturin A.S. _____ Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe vendos në mbikëqyrje të shtuar nën organin e kujdestarisë **për 10 (dhjetë) muaj**, sipas nenit 20 para (3) dhe nenit 25 të KDM-së.

Organi i kujdestarisë ka obligim:

- Të siguroj largimin e të miturit nga ndonjë ndikim negativ, sidomos duke mos kaluar kohë me të miturit tjerë që janë pjesë e kësaj lënde dhe të mos ketë qasje në rrjetin social Facebook. I mituri duhet t'ia japë fjalëkalimin e llogarisë së Facebook-ut kujdestarit të vet;

- Ta angazhojë të miturin në programe me komponentë ndëretnike.

3. Për të miturin V.B. _____ Gjykata i cakton masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe e vendos në mbikëqyrje të organit të kujdestarisë **për 1 (një) year**, në bazë të nenit 20 para (3) dhe nenin 25 të KDM-së;

Organi i kujdestarisë ka obligim:

- Të siguroj largimin e të miturit nga ndonjë ndikim negativ, sidomos duke mos kaluar kohë me të miturit tjerë që i takojnë këtij rasti dhe të mos ketë qasje në Facebook. I mituri duhet t'ia jap fjalëkalimin e llogarisë së Facebook-ut kujdestarit të vet:

- Ta angazhojë të miturin në programe me komponentë ndëretnik.

4. Për të miturin M.D. _____ Gjykata nuk cakton ndonjë masë a dënim;

5. Për të miturin B.S. _____ Gjykata nuk cakton ndonjë masë a dënim;

6. Për të miturin E.R. _____ Gjykata nuk cakton ndonjë masë a dënim.

II. Konfiskimi

Konfiskohet pistoleta Ekol Volga, EVL – _____, me gëzhjën e vet, sipas nenit 374, para 3 të KPRK.

III. Shpenzimet e procedurës

Shpenzimet e procedurës i mbulon buxheti i Kosovës sipas nenit 75 para (1) të KDM-së.

IV. Kërkesa pasurore

Palët e dëmtuara udhëzohen të ushtrojnë kërkesë pasurore juridike në kontest civil sipas nenit 75 para (1) të KDM-së.

ARSYETIM

A. ECURIA PROCEDURALE

1. Më 28 maj 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës paraqiti më 28 maj 2015 Aktvendim për Fillimin e Procedurës Përgatitore ndaj të Miturve **A.P.** _____, **A.S.** _____ dhe **V.B.** _____ për veprat penale të vrasjes së rëndë në tentativë që dyshohet se u krye më 09 prill 2015, dhe veprat penale të kërcënimit, nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit nacionale, racore, fetare ose etnike, vjedhjes dhe mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, që dzshohet se u kryen më 27 maj 2015.
2. Më 28 maj 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës paraqiti kërkesë për paraburgimin e të miturve **A.P.** _____, **A.S.** _____ dhe **V.B.** _____.
3. Në të njëjtën ditë, Prokuroria paraqiti një kërkesë për të emëruar gjyqtarët e EULEX-it për gjykimin e çështjes.
4. Më 28 maj 2015, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendimin GJA. nr. 4/15, për emërimin e gjyqtarit të EULEX-it Nuno Madureira si Gjykatës për të miturit në lëndën PprM.nr. 25/2015, në bazë të Kërkesës së Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë.
5. Pas një seance të paraburgimit, më 28 maj 2015, gjykatësi për të mitur nxori dy aktvendime që kundërshtonin kërkesën e Prokurorisë për caktimin e paraburgimit dhe në vend të saj shqiptoi masën e ndalimit të afrimit në një vend të caktuar, pra, ndalimin për të kaluar lumin Ibër në pjesën veriore të Mitrovicës dhe për të hyrë në ndonjë enklë serbe në Kosovë ndaj të miturve **A.S.** _____ dhe **V.B.** _____, dhe masën e arrestit shtëpiak ndaj të miturit **A.P.** _____, të dyja masa deri më 28 qershor 2015.
6. Më 22 qershor 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës paraqiti Aktvendim për Zgjerimin e Hetimeve, duke i zgjeruar hetimet kundër të miturit **A.P.** _____ për veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit nacional, racor, fetar ose etnik, me pretendimin të kryer më 01 qershor 2015.
7. Masa e ndalimit e shqiptuar kundër të miturve **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ u vazhdua më tej nga gjyqtari për të mitur deri në 10 gusht 2015. Më 10 gusht 2015, gjyqtari për të mitur nxori aktvendim për refuzimin e kërkesës së Prokurorisë për vazhdimin e masës së ndalimit ndaj dy të miturve, kundër të cilit Prokuroria bëri ankesë. Më 19 gusht 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin lidhur me Ankesën, PN1.1364/15 dhe PN1.1369/15, me të cilin pranoi ankesën e Prokurorisë dhe vazhdoi masën ndalimit ndaj të miturve **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ për një muaj, deri më 10 shtator 2015 .

8. Pas shkeljes së masës së arrestit shtëpiak të shqiptuar kundër të miturit **A.P.** _____, Themelore Prokuroria e Mitrovicës paraqiti më 22 qershor 2015 kërkesë për paraburgim kundër të miturit. Pas seancës së paraburgimi, gjyqtari për të mitur shqiptoi masën e paraburgimit kundër të miturit **A.P.** _____ për një muaj, deri më 25 korrik të vitit 2015. Masa u vazhdua më vonë me aktvendimin e datës 24 korrik 2015 deri më 10 gusht 2015. Me aktvendim të datës 10 gusht 2015 Gjyqtari për të mitur e refuzoi si të pabazuar Kërkesën e prokurorisë për vazhdimin e paraburgimit kundër të miturit **A.P.** _____ dhe e ndërpreu masën e paraburgimit kundër tij. Prokuroria paraqiti ankesë kundër këtij aktvendimi. Më 19 gusht 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendim lidhur me Ankesën, PN1.1364/15 dhe PN1.1369/15 me të cilin e anuloi vendimin e gjyqtarit për të mitur dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore në Mitrovicë për rigjykim.

9. Më 26 gusht 2015, një koleg për të mitur mbajti një seancë paraburgimit për të gjykuar kërkesën e Prokurorisë për vazhdimin e paraburgimit ndaj të miturit **A.P.** _____. Në të njëjtën ditë, koleg për të mitur nxori një Aktvendim me të cilin e hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për vazhdim dhe në vend të tij caktoi kundër **A.P.** _____ masën e ndalimit të afrimit në një vend të caktuar, konkretisht, ndalimin e kalimit të lumit Ibër në pjesën veriore të Mitrovicës dhe të hyrjes në ndonjë enklavë serbe në Kosovë, deri më 10 shtator 2015. Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit me Aktvendim lidhur me Ankesën, të datës 04 shtator 2015.

10. Pas kërkesave të paraqitura nga Prokuroria për të vazhduar masën e ndalimit kundër të miturve **A.S.** _____ dhe **V.B.** _____ dhe të vazhdimin të paraburgimit kundër të miturit **A.P.** _____, gjyqtari për të mitur nxori një Aktvendim më 10 shtator 2015 me të cilin e vazhdoi masën e ndalimi kundër tre të miturve për një muaj, deri më 10 tetor 2015.

11. Më 15 shtator 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës paraqiti Aktvendim për Zgjerimin e Procedurës Përgatitore, me të cilin e zgjeronte hetimin për të miturin **M.D.** _____ për Akuzat A dhe B, të miturin **B.S.** _____ për Akuzën B dhe të miturin **E.R.** _____ për Akuzën A.

12. Më 30 nëntor 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës paraqiti kërkesë për shqiptimin e masës edukative ose dënim, datë 27 nëntor 2015. Në këtë kërkesë, Prokuroria parashtron se të miturit **A.P.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **E.R.** _____ kishin kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë më 09 prill 2015 (Akuza I). Më tej, Prokuroria pretendon se i mituri **M.D.** _____ ka kryer veprën penale të kërcënimit dhe i mituri **V.B.** _____ ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës më 27 maj 2015 rreth orës 15:20 (Akuza II). Përveç kësaj, Prokuroria pretendon se më 27 maj 2015 rreth orës 16:10, të miturit **A.P.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **B.S.** _____ kryen veprat penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, të kërcënimit dhe të vjedhjes. Gjithashtu pretendohet se i mituri **V.B.** _____ ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (Akuza III). Së fundi, Prokuroria parashtron se i mituri **A.P.** _____ ka kryer veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar,

racor, fetar apo etnik më 01 qershor 2015 me anë të përdorimit të llogarisë së tij në Facebook (Akuza IV).

13. Pas një kërkesë nga gjyqtari për të mitur, Gjykata Themelore e Mitrovicës mori gjashtë hetime sociale të bëra lidhur me secilin prej gjashtë të miturve nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

14. Më 21 janar 2016, Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendimin GJA. nr. 20/16 me të cilin emëroi si gjyqtarë ndihmës znj. Kimete Fejza dhe z. Novak Mirkoviç, si anëtarë të Trupit Gjykues për të Mitur në lëndën për të mitur PPRM. 25/2015.

15. Shqyrtimi gjyqësor në lëndën PPRM. 25/2015 u caktua me Urdhër për Caktimin e Shqyrtimit më 25 janar 2016 për në datat 02, 03, 04, 05 dhe 08 shkurt 2016. Meqë shqyrtimi gjyqësor u caktua, lëndës në fjalë iu dha referenca e lëndës penale PM. 01/2016.

16. Më 29 janar 2016, Prokuroria e EULEX-it në Mitrovicë paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit të EULEX-it Nuno de Madureira si gjyqtar për të mitur dhe të Kimete Fejzas, si ndihmës gjyqtare në shqyrtimit gjyqësor në lëndën PM 01/2016 me arsyetimin se të dy gjyqtarët kishin vepruar tashmë si gjyqtarë të procedurës paraprake gjatë fazës së procedurës paraprake të kësaj lënde të njëjtë.

17. Më 01 shkurt 2016, Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendimin GJA. nr. 43/16 me të cilin e refuzoi kërkesën e Prokurorisë për përjashtimin e gjyqtarit për të mitur dhe të ndihmës gjyqtarës në këtë lëndë.

18. Shqyrtimi gjyqësor në lëndën PM 01/2016 u hap më 02 shkurt 2016.

19. Në të njëjtën ditë, Mbrojtja i bëri Gjykatës kërkesë me gojë për përjashtimin e Prokurorit të EULEX-it Pascal Persoons sipas nenit 44 paragrafi (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), me arsyetimin se ai është i martuar me një grua serbe, se lënda e tanishme është një lëndë e ndjeshme ndër-etnike dhe se Prokuroria ka treguar mungesë objektiviteti në procedurë deri në atë kohë.

20. Për shkak të kësaj kërkesë, gjyqtari për të mitur e ndërpreu shqyrtimin gjyqësor në të njëjtën ditë, derisa u mor vendim nga Kryeprokurori lidhur me atë kërkesë për përjashtim sipas KPP-së.

21. Më 03 shkurt 2016, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendim me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e Mbrojtjes për përjashtimin e Prokurorit të EULEX-it Pascal Persoons.

22. Shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë rifilloi më 04 shkurt 2016.

23. Më 04 shkurt 2016, Akuza e ndryshoi me gojë kërkesën për shqiptimin e masës edukative ose dënimit, duke e akuzuar të miturin **A.S.** _____ me veprën penale të Kërcënimit me pretendimin të kryer më 27 maj 2015 rreth orës 15:20 dhe të miturin **A.P.** _____ me veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve me pretendimin të kryer më 27 maj 2015 rreth orës 16:10. Mbrojtja nuk paraqiti asnjë kundërshtim në lidhje me vazhdimin e kërkesës për të miturit **A.P.** _____ dhe **A.S.** _____.

24. Në të njëjtën ditë, Akuza e sqaroi Gjykatën se i mituri **A.P.** _____ akuzohej sipas Akuzës IV me nenin 147 paragrafët (1) dhe (3) të KPRK-së. Në lidhje me akuzën e vjedhjes, Prokuroria e sqaroi gjithashtu Gjykatën se të miturit akuzoheshin sipas nenit 325 paragrafi (2) të KPRK-së.

25. Shqyrtimi gjyqësor vazhdoi më 05 shkurt 2016, 07, 08 dhe 22 mars 2016. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor u mbajtën të mbyllura për publikun, sipas nenit 50 paragrafi (1) dhe nenit 71 paragrafi (1) të KDM-së¹.

26. Më 24 mars 2016, pas diskutimeve të mbajtura në bazë të nenit 357 paragrafi (2) të KPP-së, trupi gjykues për të mitur gjeti se ekziston nevoja për të ri-hapur shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të plotësohej procedura siç parashikohet në nenin 359 paragrafi (1) të KPP-së. Në të njëjtën ditë, gjyqtari për të mitur ri-hapi shqyrtimin gjyqësor dhe nxori një urdhër me gojë me të cilin urdhëroi ekspertimin e pistoletës ref. E. _ V. _ nr. serial. EVL-_____ të sekuestruar nga Policinë e Kosovës në Mitrovicën e Veriut më 27 maj 2015.

27. Shqyrtimi gjyqësor vazhdoi më 15 prill 2016 dhe u mbyll në të njëjtën ditë.

28. Trupi gjykues për të mitur u këshillua më 15 prill 2016.

29. Dispozitivi i aktvendimit u njoftua më 18 prill 2016.

30. Shqyrtimi gjyqësor u krye sipas dispozitave të KDM-së pasi të gjashtë të miturit ishin nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç në kohën e kryerjes së veprave të pretenduara penale.

31. Në bazë të nenit 541 të KPP-së, i cili hyri në fuqi më 01 janar 2013, shqyrtimi gjyqësor u zhvillua në bazë të dispozitave të KPP të ri.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

32. Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 (LGJ) hyri plotësisht në fuqi më 01 janar 2013 (neni 43). Ky Ligj rregullon juridiksionin territorial dhe lëndor të gjykatës.

¹ Kodi nr. 03/L-193.

33. Në nenin 11 paragrafi (1) të Ligjit për Gjykatat, gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha lëndët, përveç atyre të parapara ndryshe me ligj.

34. Neni 9 Paragrafi (2) Nën-paragrafi (2.7) i të njëjtit Ligji deklaron se Gjykata Themelore e Mitrovicës themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë. Bazuar në kërkesën e parashtruar për shqiptimin e masës edukative ose të dënimit, veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në jug dhe veri të Mitrovicës, pra, brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29 paragrafi (1) të KPP-së. Për më tepër, duke pasur parasysh se kërkesa për fillimin e procedurës përgatitore ishte paraqitur së pari, në atë kohë, në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, në bazë të nenit 29 paragrafi (2) të KPP-së, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka juridiksion në këtë lëndë.

35. Për më tepër, më 28 maj 2015, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendimin GJA.nr.4/15, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin lidhur me mandatin e i Misionit të Bashkimit Evropian të Sundimit të Ligjit në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 5 pika (1) të Marrëveshjes ndërmjet shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në aspektet përkatëse të veprimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarët të EULEX-it me gjyqtarët vendorë, duke emëruar gjykatësin e EULEX-it Nuno Madureira si Gjykatës për të miturit në lëndën PprM. nr. 52/2015 në bazë të kërkesës së Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë.

36. Pas paraqitjes së kërkesës së Prokurorisë për caktimin e masës edukative ose dënimit, më 21 janar 2016, ushtruesi i detyrës së kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxori Aktvendimin GJA.nr.20/16 duke emëruar Kimete Fejzën dhe Novak Mirkoviçin si ndihmës- gjyqtarë të trupit gjykues për lëndën për të mitur, PprM. nr. 25/2015 për të vendosur lidhur datat e ardhshme të shqyrtimit gjyqësor.

37. Prandaj, Trupi gjykues për të mitur në lëndën PM 01/2016 është kompetente për të gjykuar këtë lëndë në shqyrtim gjyqësor

C. SHQYRTIMI GJYQËSOR

38. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor ishin të mbyllura për publik në bazë të nenit 50 paragrafi (1) dhe Nenin 71 paragrafi (1) të KPM-së dhe u mbajtën më 02, 04 dhe 05 shkurt 2016, 07, 08, 22 dhe 24 mars 2016, dhe 15 prill 2016.

39. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të 04 shkurtit 2016, të gjashtë miturit u vetë-deklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat, përveç të miturit **A.P.** _____ i cili u deklarua fajtor vetëm për akuzën e kërcënimit më 27 maj 2015.

D. PROCEDURA E PROVAVE

i) Provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor

40. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u dëgjuan dëshmitarët e mëposhtëm:

- B.I. _____ (i thirrur si dëmtuarit dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 04 shkurt 2016;
- Z.K. _____ (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 04 shkurt 2016;
- N.S. _____ (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 05 shkurt 2016;
- A.Z. _____ (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 07 mars 2016;
- K.D. _____ (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 07 mars 2016;
- Nikola Mojsiq (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga Prokuroria) u dëgjua më 07 mars 2016;
- L.J. _____ (i thirrur si dëshmitar nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar) u dëgjua më 07 mars 2016;
- S.D. _____ (i thirrur si dëshmitar nga Gjykata) u dëgjua më 07 mars 2016.

41. Gjatë seancës gjyqësore të 08 marsit 2016, u paraqit si provë dhe u konsiderua e pranueshme lista e dokumenteve në Dosjen e Prokurorisë:²

- 1. Kallëzimet penale, faqet 10-18;
- 2. Kontrolli i të kaluarës kriminale - **A.P.** _____, faqet 19-21;
- 3. Kontrolli i të kaluarës kriminale - **V.B.** _____, faqet 22-24;
- 4. Kontrolli i të kaluarës kriminale - **M.D.** _____, faqet 25-26;
- 5. Raporti fillestar i incidentit, 2015-SA-104, faqet 27-28;
- 6. Raporti i shkurtër, KP M.P. _____ # 9644, faqet 29-31;
- 7. Raporti i oficerit të PK-së Z.V. _____ # 9564, faqet 32-34;
- 8. Raporti i oficerit të PK-së M.P. _____ # 9644, faqet 35-37;
- 9. Raporti i oficerit të PK-së P.S. _____ # 9451, faqet 38-40;
- 10. Raporti i oficerit të PK-së A.J. _____ # 9389, faqet 41-43;
- 11. Raporti i oficerit të PK-së A.B. _____ # 9298, faqet 44-46;
- 12. Raporti i oficerit të PK-së M.M. _____ # 8361, faqet 47-49;
- 13. Raport i shkurtër, PK G.M. _____ # 9451, faqet 50-52;
- 14. Raporti i informacionit hetimor, KP G.M. _____ # 9451, faqet 53-62;
- 15. Raporti i Oficeres së PK-së F.V. _____ # 4101, faqet 63-65;
- 16. Memo zyrtare e PK-së - Dorëzimi i rastit 2015-SI-038 për nevojat e IPK-së, faqet 66-70;
- 17. Memo zyrtare e PK-së - Kërkesa për të shkarkuar video incizimet, faqet 71-74;
- 18. Raporti i oficeres së PK-së F.V. _____ # 4101, faqet 75-77;
- 19. Emaillet lidhur me video incizimet nga kamerat në urë, faqet 81-83;
- 20. Raporti i oficerit të PK-së L.M. _____ # 9539, faqet 84-86;
- 21. Raporti i oficerit të PK-së .B. _____ # 7825, faqet 87-89;
- 22. Memo zyrtare e PK-së - Dorëzimi i deklaratës së viktimës, faqet 90-92;

² Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08 mars 2016, para. 60, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 18.

- 23. Raporti fillestar i incidentit, 2015-SA-169, faqet 93-101;
- 24. Raporti i oficerit të PK-së K.N. _____ # 9634, faqet 102-104;
- 25. Raporti i oficerit të PK-së togerit Z.R. _____ # 9529, faqet 105-110;
- 26. Raporti i oficerit të PK-së N.S.1 # 9380, faqet 111-113;
- 27. Raporti i oficerit të PK-së L.J. _____ # 6611, faqet 114-116;
- 28. Raporti i oficerit të PK-së N.S.1 # 9380, faqet 117-119;
- 29. Raporti Special i BPO, PK, F.V. _____ # 4101, faqet 120-125;
- 30. Raporti i oficerit të PK-së M.S. _____ # 5984, faqet 126-131;
- 31. Raporti i oficerit të PK-së M.B. _____ # 7348, faqet 132-134;
- 32. Dy foto dorëzuar PK-së nga Z.K.1 _____ nga D.K. _____, faqet 135-136;
- 33. Raporti i oficerit të PK-së Z.K.1 _____ # 9647, faqet 137-139;
- 34. Memo zyrtare e PK-së - Përgjigja për urdhrin GJPP.nr. 25/15, faqet 140-142;
- 35. Raport mbi ecurinë e hetimeve, PK M.B. _____ # 7348, faqet 149-151;
- 36. Përmbajtja e dosjes mjeko-ligjore, faqet 152-154;
- 37. Raporti hetimor i këqyrjes së vendit të ngjarjes, KP G.M.1 _____ # 7521, faqet 155-160;
- 38. Lista e rrobave të marra nga viktima N.S. _____, fq. 161-163;
- 39. Lista e provave/Zinxhiri i ruajtjes, D2-D9, faqet 164-166;
- 40. Foto-albumi nr. 15-016, PK G.M.1 _____ # 7521, faqet 167-182;
- 41. Regjistri i hyrjes në vendin e ngjarjes, faqet 183-185;
- 42. Foto-albumi nr. 15-028, PK G.M.1 _____ # 7521, faqet 186-200;
- 43. Lista e sendeve të konfiskuara nga **A.P.** _____, faqet 201-202;
- 44. Lista e sendeve të konfiskuara nga **V.B.** _____, faqet 203-204;
- 45. Dorëzimi i pamjeve të marra nga gazetari, A / V - CD bashkangjitur, datë 27 maj 2015, faqet 205-207;
- 46. Lista e provave/zinxhiri i ruajtjes së provave, D11, faqet 208-209;
- 47. Imazhet e nxjerra nga llogaritë e të pandehurve në Facebook, faqet 210-224;
- 48. Memo zyrtare e KP-së - Dorëzimi i fotografive të pastruara nga Forenzika, faqet 225-227;
- 49. Raporti i oficerit t, PK-së R.Z. _____ # 7500, faqet 228-233;
- 50. Foto-albumi - video incizimet - CD e bashkangjitur nga incidenti i 9 prillit 2015, faqet 234-241;
- 51. Raportet Mjekësore - N.S. _____, faqet 242-260;
- 52. Sendet e konfiskuara nga **A.P.** _____ (të përmendura në faqen 201 të listës);
- Të gjitha fotot në Facebook bashkangjitur deklaratave të të pandehurit

42. Në lidhje me sendet e konfiskuara, u mbajtën si provë këto sende:

- Një thikë, në ngjyrë të zezë, me mbishkrimin ‘UÇK’;
- Një thikë në ngjyrë kafe, me dorezë druri;
- Një thikë në ngjyrë gri;
- Një pistoletë e llojit E. _____ V. _____, nr. ser. EVL- _____, me krehër;
- Një telefon, marka SAMSUNG;
- Një shall me mbishkrimin ‘shqiptar’ - me simbolet e ‘Shqipërisë së Madhe’;
- Një maskë gazi, me ngjyrë të gjelbër, pa filtër ajri;
- Katër flamujt të Republikës së Serbisë;

- Një flamur i Republikës së Shqipërisë;
- Një çantë shpine shkollore me libra.

43. Pas seancës së këshillimit të mbajtur më 24 mars 2016 dhe vendimit të Trupit gjyqësor për të mitur për të ri-hapur shqyrtimin gjyqësor për të plotësuar procedurën siç parashikohet në nenin 359 paragrafi (1) të KPP-së, Gjykata nxori një Urdhër për Ekzaminim Forenzik të pistoletës, ref. E. ____ V. ____, nr. ser. EVL-____, datë 24 mars 2016. Më 13 prill 2016, Gjykata mori një raport balistik të datës 30 mars 2016, që u pranua si provë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 15 prill 2016.

44. Asnjë nga të miturit nuk dha deklaratë gjatë shqyrtimit gjyqësor të 08 marsit 2016.

45. Megjithatë, të dy të miturit, **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____, deklaruan gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të 08 marsit 2016 se të dy qëndronin pas deklaratave të tyre të dhëna para policisë dhe Prokurorisë.

46. Pas ri-hapjes së shqyrtimit gjyqësor më 24 mars 2016 dhe bashkëngjijtes së raportit balistik në këtë lëndë si provë, të miturit **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ dhanë deklaratë më 15 prill 2016.

ii) *Kërkesat e palëve*

47. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjyqësor për të mitur mori kërkesat e mëposhtme lidhur me provat, dhe nxori aktvendimet e mëposhtme.

- Kërkesë për ekzaminimin e provave, më datë 08 shkurt 2016, dhe të paraqitur nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar më 12 shkurt 2016

48. Më 12 shkurt 2016, përfaqësuesi i palës së dëmtuar paraqiti kërkesë për shqyrtimin e provave, duke kërkuar të merret në pyetje një profesionist mjekësor gjatë shqyrtimit gjyqësor për të dhënë një opinion lidhur me plagët e marra nga pala e dëmtuar N.S. _____ dhe për të thirrur _____ L.J. _____ si dëshmitar meqë ai paraqiti raportet e policisë lidhur me arrestimin e të miturve më 27 maj 2015.

49. Kërkesa për të thirrur _____ L.J. _____ u pranua me aktvendim gojor të datës 07 mars 2016 në bazë të nenit 329 paragrafi (3) të KPP-së.

50. Kërkesa për të thirrur një profesionist mjekësor u refuzua në bazë të nenit 258 paragrafi (2), nën-paragrafët (2.1) dhe (2.4) të KPP-së. Megjithatë, në bazë të nenit 329 paragrafi (4) të KPP-së, Gjykata vendosi të pyesë _____. S.D. _____ si dëshmitar.

- Kërkesa për të pranuar si prova njëmbëdhjetë (11) fotografitë në faqen e Facebook-ut të të dëmtuarit K.D. _____

51. Gjatë seancës gjyqësore të 07 marsit 2016, Mbrojtësi Rexhep Kaçaniku dorëzoi një kërkesë për të pranuar njëmbëdhjetë (11) fotografi të faqes në Facebook të të dëmtuarit *K.D.* _____.

52. Kërkesa u refuzua pasi fotografitë nuk kanë lidhje me lëndën në fjalë.

E. GJETJET FAKTIKE

E.1. Përmbledhje e fakteve të provuara

53. Gjykata duhej të vendoste se cilat fakte janë vërtetuar në bazë të provave të administruara të paraqitura kundër të miturve **A.P.** _____, **A.S.** _____, **V.B.** _____, **M.D.** _____, **B.S.** _____ dhe **E.R.** _____ për veprat penale të:

- Akuza I: ‘Vrasje e rëndë në tentativë’, kundër të Miturve **A.P.** _____, **A.S.** _____, **V.B.** _____, **M.D.** _____ dhe **E.R.** _____;
- Akuza II: ‘Kërcënimi’, kundër të miturve **V.B.** _____, **M.D.** _____ dhe **A.S.** _____ dhe ‘mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të armëve kundër të miturit **V.B.** _____;
- Akuza III: ‘nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit nacional, racor, fetar ose etnik’, ‘kërcënimi’ dhe ‘vjedhje’, kundër të miturve **A.P.** _____, **A.S.** _____, **V.B.** _____, **M.D.** _____, dhe **B.S.** _____ dhe ‘mbajtje në pronësi, kontroll ose posedimi të paautorizuar të armëve’, kundër të miturve **V.B.** _____ dhe **A.P.** _____.
- Akuza IV: ‘Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik’, kundër të miturit **A.P.** _____.

54. Pas provave të pranueshme të paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata vlerësoi këto fakte relevante të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm:

I. Pesë të rinj shqiptarë, në mesin e tyre **A.P.** _____, **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____, vendosën së bashku të kalojnë urën kryesore të Mitrovicës nga veriu në jug, me qëllimin për të sulmuar dhe dëmtuar qytetarët e përkatësisë etnike serbe.

II. Në përputhje me marrëveshjen e tillë, më 9 prill 2015, rreth orës 17:55, të pesë të rinjtë kaluan Urën kryesore të Mitrovicës dhe, në mes të Monumentit të Bardhë dhe urës kryesore në Mitrovicën e veriut, ata sulmuan në befasi tre të rinj serbë, përkatësisht **N.S.** _____, i lindur më _____, **B.I.** _____, i lindur më _____ dhe **Z.K.** _____, i lindur më _____.

III. **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe të rinj të tjerë sulmuan **B.I.** _____, **Z.K.** _____ dhe **N.S.** _____ me grushte dhe shqelma, duke i grushtuar dhe shqelmuar në disa pjesë të trupit.

IV. Gjatë sulmit **A.P.** _____ vendosi më nizmën e vet t'i ngulë thikën N.S. _____ me një thikë, duke e goditur në gjoks nga mbrapa, kur N.S. _____ ishte kthyer për të ikur.

V. Si pasojë e sulmit, N.S. _____ pësoi një lëndim depërtues në anën e djathtë të gjoksit, që shkaktoi leziona të mëlçisë, diafragmës dhe mushkërisë së djathtë. N.S. _____ u transportua menjëherë në spital dhe iu nënshtrua operacionit. Ai qëndroi në spital deri më 27 prill 2015. Pa trajtim N.S. _____ do të kishte pasur gjakderdhje deri në vdekje.

VI. **A.P.** _____ theri qëllimisht me thikë N.S. _____ në zonën e gjoksit, sepse ky i fundit ishte i përkatësisë etnike serbe. Ai parashikoi në mënyrë të mjaftueshme se veprimi i tij mund të shkaktonte vdekjen e këtij të fundit dhe e pranoi këtë pasojë.

VII. **A.P.** _____ ishte plotësisht i aftë mendërisht.

VIII. **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe të rinj të tjerë vepruan së bashku vullnetarisht dhe qëllimisht goditën N.S. _____, **B.I.** _____, dhe **Z.K.** _____ me dëshirën për t'i lënduar, sepse ata ishin të përkatësisë etnike serbe.

IX. **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ ishin plotësisht të aftë mendërisht.

X. Më 27 maj 2015, rreth orës 15:20, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe një tjetër djalë vendosën të shkojnë së bashku për të auto-larje që ndodhet në Rrugën Kolasinska, afër Tre Rrokaqiejve në Mitrovicën e veriut.

XI. Në auto-larje ishte **A.Z.** _____ (i lindur më _____), i cili punonte atje, së bashku me shokët e tij **K.D.** _____ (i lindur më _____) dhe **N.M.** _____ (i lindur më _____).

XII. Kur ishin atje, **A.S.** _____ dhe i riu tjetër nxorën thika dhe u nisën drejt **K.D.** _____, **N.M.** _____ dhe **A.Z.** _____, ndërsa **V.B.** _____ nxori një pistoletë **E.** _____ **V.** _____, nr. serik EVL-_____, dhe ua drejtoi të treve.

XIII. Pistoleta ishte projektuar për përdorut plumba me gaz 9 mm. Megjithatë, tyta e pistoletës ishte riprojektuar për ta përdorur atë si armë zjarri me plumba të kalibrit 6.35x15mm. Gjilpëra e shkrepjes, mekanizmi i qitjes dhe shuli nuk ishin funksionale dhe për këtë arsye arma nuk ishte funksionale.

XIV. **K.D.** _____ dhe **N.M.** _____ filluan të vrapojnë drejt urës kryesore për të raportuar incidentin.

XV. Pastaj Njëri prej të miturve bëri gjeste përpara **A.Z.** _____, duke lëvizur njëren dorë përmes fytyrës së tij dhe duke treguar tek **K.D.** _____ dhe **N.M.** _____.

XVI. **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ vepruan vullnetarisht së bashku me dëshirën për të frikësuar N.M. _____ dhe A.Z. _____, sepse ata ishin të përkatësisë etnike serbe.

XVII. **V.B.** _____ nuk kishte leje të vlefshme për atë armë, të lëshuar nga një autoritet kompetent, dhe ishte i vetëdijshëm për këtë.

XVIII. **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ ishin plotësisht të aftë mendërisht.

XIX. Disa ditë më vonë, K.D. _____ mori me anë të Facebook-ut dy fotografi të dërguara atij nga i mituri **V.B.** _____, që përshkruante një grup prej pesë fëmijësh që mbanin thika dhe fotoja e dytë përshkruante të miturin **V.B.** _____ para ndërtesës ku jeton K.D. _____.

XX. Më 27 maj 2015, rreth orës 16:10, **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, dhe **B.S.** _____ kaluan urën kryesore të Mitrovicës nga veriu në jug.

XXI. **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ pastaj shkuan në varrezat myslimane, hoqën katër flamuj serbë, sepse prania e tyre i shqetësonte ata, dhe i vunë në një çantë shpine.

XXII. Në kthim për në pjesën jugore të Mitrovicës, **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, dhe **B.S.** _____ gati u përfshinë në konfrontime fizike me një grup qytetarësh të nacionalitetit serb, të cilët po shkonin pas të miturve.

XXIII. Ndërsa po ecte, **V.B.** _____ mbajti në dorë në një moment të caktuar pistoletën E. _____ V. _____, numër serik EVL-_____ dhe bënte gjeste me të.

XXIV. Policia ndërhyri dhe arriti të kapë **A.P.** _____, **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____, ndërsa **M.D.** _____ dhe **B.S.** _____ arritën të largohen nga vendngjarja.

XXV. Në atë kohë **A.P.** _____ kishte pistoletën E. _____ V. _____, numër serik EVL-_____ në të brendshmet e tij, ngjitur me trupin.

XXVI. **A.P.** _____ gjithashtu mbante në një çantë shpine tre thika (një me emblemë të UÇK-së), një maskë gazi, një shall të 'Shqipërisë së Madhe' dhe një flamur shqiptar.

XXVII. **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ e dinin se flamujt nuk u përkasin atyre dhe vepruan me qëllimin për të mos i kthyer ata.

XXVIII. As **V.B.** _____, as **A.P.** _____ nuk kishin leje të vlefshme për pistoletën, të lëshuar nga një autoritet kompetent, dhe ishin të vetëdijshëm për këtë.

XXIX. **V.B.** _____ dhe **A.P.** _____ ishin plotësisht të aftë mendërisht.

XXX. Më 1 qershor 2015, **A.P.** _____ postoi në Facebook një foto në llogarinë e tij, ku ai është duke djegur një flamur serb.

XXXI. Ky postim shkaktoi shumë komente mbështetëse të shkruara në gjuhën shqipe dhe të paktën një koment të shkruar në alfabetin cirilik.

XXXII. I mituri **A.P.** _____ vjen nga një familje shumë e varfër me probleme sociale dhe financiare. Ai nuk shkon në shkollë rregullisht. Pjesëmarrja e tij e parregullt e ka shkaktuar përjashtimin e tij nga shkolla e mesme. Ai ka qenë nxënës i rregullt, me sjellje të mirë, por kohët e fundit në vitin 2015 ai filloi të mungojë dhe të lërë mësimin. Nëna e tij ka vënë re një ndryshim tek ai kohët e fundit dhe se ai po shkaktonte probleme dhe shoqërohej me shoqëri të keqe. I mituri konsiderohet i qetë, i tërhequr në mendimet dhe të shprehurit e tij, por bashkëpunues dhe komunikues. Ai është në gjendje të mirë shëndetësore. Ai është i njohur për Shërbimin e Sprovës pasi ai është regjistruar si i dyshuar për kryerjen e një krimi në lëndën PPM nr. 16/2015. Ai ka kaluar shumë muaj në Qendrën Korrektuese të Paraburgimit në Lipjan sipas një urdhri të një gjykatës në një lëndë tjetër.

XXXIII. I mituri **A.S.** _____ vjen nga një familje me kushte të mira financiare. I mituri ndjek shkollën dhe konsiderohet si nxënës shumë i mirë. Ai gëzon shëndet të mirë fizik dhe mendor, ai është i komunikueshëm dhe shumë i qetë dhe ka pjekuri.

XXXIV. I mituri **V.B.** _____ vjen nga një familje me kushte të mira jetese. I mituri ndjek shkollën dhe konsiderohet si nxënës i sjellshëm, me nota shumë të mira. Ai gëzon shëndet të mirë fizik dhe mendor, është mirëdashës dhe bashkëpunues, ka marrëdhënie të mira ndër-familjare.

XXXV. I mituri **E.R.** _____ vjen nga një familje me kushte të mira jetese. I mituri ndjek shkollën dhe konsiderohet si nxënës i sjellshëm dhe me nota të kënaqshme. Ai gëzon shëndet të mirë fizik dhe mendor, është komunikues dhe person i qetë në familje.

XXXVI. I mituri **M.D.** _____ vjen nga një familje shumë e varfër. I mituri ndjek shkollën dhe konsiderohet si nxënës me sjellje të mirë dhe me nota mesatare. Ai gëzon shëndet të mirë fizik dhe mendor, është komunikues dhe bashkëpunues, ka marrëdhënie të mira ndër-familjare.

XXXVII. I mituri **B.S.** _____ vjen nga një familje me kushte të mira jetese dhe ekonomike. I mituri ndjek shkollën dhe konsiderohet si student i sjellshëm dhe i mirë. Ai gëzon shëndet të mirë fizik dhe mendor, është i komunikueshëm dhe ka marrëdhënie të mira ndër-familjare.

E.2. Përmbledhje e fakteve të paprovuara

55. Nuk u arrit të provohen sa më poshtë:

I. Se më 9 prill 2015, **M.D.** _____ dhe **E.R.** _____ ishin pjesë e grupit të pesë të rinjve shqiptarë.

II. Se më 27 maj 2015, **M.D.** _____ ishte i pranishëm gjatë incidentit në auto-larje.

III. Se më 27 maj 2015, **A.S.** _____, **M.D.** _____ dhe **B.S.** _____ morën katër flamuj serbë nga varrezat myslimane.

IV. Se më 27 maj 2015, **A.P.** _____ nxori një thikë.

E.3. Analiza

56. Provat e listuara më sipër (D. Procedura e provave) formon bazën për vendimin e trupit gjykues për të mitur në këtë lëndë.

57. Siç u përmend, trupi gjykues për të mitur ka shqyrtuar dëshmitë e disa dëshmitarëve, si dhe analizoi disa dokumente për të vërtetuar faktet e pretenduara.

E.3.1 Akuza I

58. Në lidhje me faktet e 9 prillit 2015, pjesa më e rëndësishme e provave është prova materiale D # 7³, e cila është një CD që përmban një video filmim 9m 21s nga një kamera në rrugë e vendosur në Mitrovicën e veriut dhe përballë me urën kryesore. Videoja është me ngjyra dhe cilësia është e mirë, pa asnjë mungesë. Kamera regjistron nga një këndvështrim shumë i lartë, kështu që madhësia relative e njerëzve është e të miturin. Fytyrat nuk është e mundur të dallohen. Megjithatë, veprimet e njerëzve janë qartësisht të perceptueshme.

59. Regjistrimi fillon në orën 17:55:55. Në anën e majtë të Ibar Ribar-it, në afërsi të urës, një grup prej tre të rinjsh mund të shihet duke bërë një bisedë. Në anën e djathtë të lumit, duke ardhur nga larg, një grup prej pesë të rinjsh janë duke ecur pranë njëri-tjetrit përgjatë bregut të lumit. Ky grup nuk ndalon kurrë, nuk ndalet kurrë. Ai kalon urën dhe, një minutë e pesëdhjetë sekonda më vonë, është fill pas tre të rinjve në veri të Mitrovicës. Ajo që vijon nuk është kapur në kamera, por dhjetë sekonda më vonë grupi që kaloi urën mund të shihet duke u kthyer me vrap në drejtim të jugut.

60. Megjithatë ky regjistrim është i mjaftueshëm për të krijuar disa fakte vendimtare. Së pari, grupi që vjen nga jugu ka një qëllim të veçantë dhe të para-përcaktuar për të kaluar urën. Kjo është e qartë pasi që në fillim ky grup nuk tregon shenjën më të të miturin të hezitimit. Së dyti, nuk ka asnjë provokim nga grupi i tre të rinjve. Së treti, nga pesë anëtarët e grupit që kaloi urën, një djalë nuk ka kryer asnjë nga veprimet e përshkuara në kërkesën e prokurorit, pasi ai është dukshëm gjatë gjithë kohës në pamjet video dhe nuk vjen në kontakt me viktimat. Së katërti, fill para se të dalin jashtë kornizës së kamerës, të tre të rinjtë janë me shpinë ndaj grupit që vjen nga jugu.

³ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 235.

61. Identiteti i tre personave që ishin në veri është i njohur: ai përbëhet nga N.S. _____, B.I. _____ and Z.K. _____, palët e dëmtuara. Ajo që ata i thanë Gjykatës është vërtetuar shumë nga pamjet e kamerës, një rrethanë që shton besueshmërinë e deklaratave të tyre në gjykatë. Deklaratat e dëshmitarëve të mëparshëm nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë, në bazë të nenit 123, paragrafi (3), të KPP-së dhe nuk do të merren parasysh.

62. Të tre personat e dëmtuar përmendën se ata kishin shkuar në atë vend për një shëtitje dhe bisedë. Gjithashtu, se ata tashmë ishin nisur për në shtëpi (ata jetojnë në Mitrovicën veriore), kur ata dëgjuan disa zëra që vinin nga pas. Kur kthyen kokat, ata panë pesë ose gjashtë të rinj, të cilët u thanë diçka me shumë të ngjarë në gjuhën shqipe. Pastaj çdo gjë ndodhi shumë shpejt. Të tre prej tyre u shqelmuar dhe grushtuan dhe më pas, kur N.S. ktheu shpinën dhe filloi të largohet me vrap, ai u godit me thikë nga mbrapa.

63. Palët e dëmtuara përmendën të gjithë se disa sulmues nxorën thika në një moment gjatë sulmit.⁴

64. Palët e dëmtuara nuk i njihnin dhe nuk e kishin parë sulmuesit më parë⁵. Gjatë ekzaminimit të tyre në gjykatë, B.I., Z.K. dhe N.S. mbajtën mend fytyrat e **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____. N.S.____ po ashtu tha se fytyra e **A.S.** _____ dukej e njohur.⁶

65. Gjatë hetimit, u krye një procedurë për identifikimin e personave në përputhje me nenin 120 të KPP-së. N.S.____ identifikoi pozitivisht **V.B.** _____ (n. 4.), **A.P.** _____ (n. 10.) dhe **A.S.** _____ (n. 15.)⁷; B.I.____ identifikoi **V.B.** _____ (n. 4) dhe dikë i cili nuk është asnjëri nga të miturit (n. 109)⁸. Z.K.____ identifikoi **V.B.** _____ (n. 4) dhe **A.P.** _____ (n. 10)⁹.

66. Vetëm **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ dhanë deklaratat e gjykatës, duke qëndruar pranë çdo gjëje që kishin thënë më parë në Polici dhe Prokurori. Duke riprodhuar në gjykatë deklaratat e tyre të mëparshme, ajo që ata thanë më parë të mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë, pa kufizimin e vendosur nga neni 123, paragrafi (5), i KPP-së, domethënë, deklaratat e tyre mund të përdoren si prova e vetme apo vendimtare kundër tyre. Të dy të miturit pranojnë se kanë marrë pjesë në ngjarjet, megjithëse **V.B.** _____ mohoi të ishte angazhuar në ndonjë kontakt fizik. Ai identifikoi të miturin **E.R.** _____ si i fundit i grupit, ai i cili nuk bëri asgjë¹⁰.

⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 04 shkurt 2016, paragrafët 196-204, 212-214, 236-247, 354-357, 395-400, 419-436, 474, 535-536, 576-577. Lidhja III e Gjykatës, Tabela 4.

⁵ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 04 shkurt 2016, paragrafët 237-242, 407-440, 447-454., 457-460, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 05 shkurt 2016, paragrafët 35-39, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 6.

⁶ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 05 shkurt 2016, paragrafët 35-39, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 6.

⁷ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 343.

⁸ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 359.

⁹ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 374.

¹⁰ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 943.

67. I mituri **A.S.** _____ gjithashtu pranoi në Intervistën në Procedurën Paraprake se kishte qenë pjesë e këtij grupi¹¹. Në përputhje me nenin 123, paragrafi (5), i KPP-së, kjo njohje nuk mund të jetë prova e vetme apo vendimtare fajësuese për dënim.

68. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, **Z.K.** _____ identifikoi **V.B.** _____ si njëri prej personave që e shqelmoi dhe grushtoi.

69. Duke marrë parasysh deklaratat e viktimave, procedurën e identifikimit dhe pranimin e tre të miturve të përmendur, Gjykata u bind se **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe një person i katërt sulmuan së bashku palët e dëmtuara, pa asnjë provokim dhe në befasi. Pranimi i të miturit **A.S.** _____ nuk është as i vetmi burim provash kundër tij, as ai vendimtar kur është fjala për të vendosur lidhur me fajësinë e tij, duke pasur parasysh fuqinë e procedurës së identifikimit të personave të përmendur më lart në paragrafin 64.

70. Gjithashtu, duke marrë parasysh deklaratën e **Z.K.** _____, ku ai identifikon të miturin **A.P.** _____ si ai që sulmoi shokun e tij **N.S.** _____, dhe vetë Intervistën e të miturit në Procedurës Paraprake, ku i mituri pranon goditjen me thikë, Gjykata arriti në përfundimin se ai ishte i vetmi i cili përdori thikën gjatë sulmit.

71. Gjykata gjithashtu arriti në përfundimin se të tre sulmuesit e tjerë, edhe pse nxorën thika, nuk synuan kurrë t'i përdorin, pasi në të vërtetë ata nuk i përdorën kur ata mund ta bënin lehtë këtë. Në vend të kësaj, ata vetëm shqelmuuan dhe grushtuan. Gjykata e përdorur këtë rrethanë për të vendosur se qëllimi i tyre nuk ishte për të vrarë, por vetëm për të lënduar fizikisht viktimat.

72. I njëjti përfundim nuk është i vlefshëm për **A.P.** _____. Ai përdori një objekt të mprehtë, shpues dhe goditi një person tjetër në zonën e gjoksit. U godit një mëlçi, diafragmë dhe mushkëri. Duke marrë parasysh armën e përdorur, zonën e trupit të shënjestruar – zona e kraharorit që përmban disa organe vitale – dhe forcën e përdorur – e mjaftueshme që thika të arrinte tre organe, i mituri mund ta parashikonte lehtë rrezikshmërinë e veprimeve të tij. Ai e pranoi në mënyrë të qartë çdo pasojë që mund të shkaktohej nga veprimi i tij.

73. Motivet etnike prapa sulmit janë të qarta: të miturit i sulmuan të rinjtë për vetë faktin se ata ishin serbë dhe ish shqiptarë. **A.P.** _____ është mjaft i qartë në këtë drejtim gjatë intervistës së tij në procedurën paraprake.

74. Meqë asnjë fytyrë nuk u regjistrua nga ndonjë kamera, meqë viktimat nuk njohën sulmues të tjerë dhe meqë ata vetë nuk dëshmuuan në gjyq, a ka ndonjë provë se **M.D.** _____ dhe **E.R.** _____ ishin të pranishëm në vendin e krimit?

75. I mituri **E.R.** _____ pranoi se ishte me miqtë e tij **V.B.** _____, **A.P.** _____ dhe **A.S.** _____ gjatë ekzaminimit të tij në procedurën paraprake¹². Në bazë të nenit 123, paragrafi (5), të

¹¹ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 687.

¹² Lidhja I e Prokurorisë, faqe 653.

KPP-së, të përmendur tashmë, deklaratat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të pranueshme kundër këtij të pandehuri, por nuk mund të shërbejnë si provë e vetme ose vendimtare fajësuese për dënim. Gjithashtu, në deklaratat e tyre të mëparshme **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ përmendën **M.D.** _____ dhe **E.R.** _____ si pjesë të grupit. Në paragrafin 66 më lart, deklarata e **V.B.** _____ është përdorur edhe në favor të **E.R.** _____. Përsëri, në bazë të nenit 262, paragrafi (1), të KPP-së, Gjykata nuk mund ta gjejë një të akuzuar fajtor vetëm, ose në masë vendimtare, duke u bazuar në dëshminë ose prova të tjera që të pandehurit ose mbrojtësit nuk kanë mundur t' kundërshtojnë përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës. As të miturit **M.D.** __ dhe **E.R.** __ dhe mbrojtësit e tyre nuk qenë në gjendje ta bënin këtë. Në fakt, ata nuk qenë të pranishëm gjatë ekzaminimeve të shumta gjatë hetimeve të **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____. Megjithatë ata ishin gjatë shqyrtimit gjyqësor, por këta dy të mitur përdorën të drejtën e tyre për të mos iu përgjigjur pyetjeve dhe, për këtë arsye, u bë e pamundur të pyeten drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

76. Si përfundim, deklaratat e të miturve **A.S.** _____, **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ nuk mund të përdoren kundër **M.D.** __ dhe **E.R.** __ pasi ato janë prova e vetme dhe vendimtare kundër këtyre të fundit.

77. Raportet mjekësore të dorëzuara nga Qendra Shëndetësore e Mitrovicës janë mjaft të sakta në përcaktimin e plagëve të marra nga N.S. _____ për shkak të plagës me thikë¹³. Dëshmitari S.D. _____, _____, ishte pjesë e _____ që trajtoi të miturin pas mbërritjes së tij në spital. Ai konfirmoi se lëndimet e mëlçisë dhe mushkërive të pësura nga ana e pacientit do të kishin bërë që ai të kishte gjakderdhje deri në vdekje nëse nuk do të ishin trajtuar në kohën e duhur¹⁴. Njohuritë mjekësore të mjekut u gjetën të mjaftueshme për të përcaktuar një fakt të tillë dhe prandaj Gjykata nuk gjeti arsye për të urdhëruar ekspertizë. Nuk iu dha rëndësi faktit se ky mjek nuk ka licencë për të praktikuar në Kosovë, të dhënë nga autoritetet e Kosovës. Situata politike në Mitrovicën e në veriut është e njohur dhe aftësitë e _____ janë më të rëndësishme se miratimi burokratik i tij.

E.3.2 Akuza II

78. Në lidhje me faktet nën pikën II, Gjykata dëgjoi tre viktimat, domethënë **A.Z.** _____, **K.D.** _____ dhe **N.M.** _____. Të gjithë ata kanë përkrahje të ngjashme në incidentit. Ata përkrahën se çfarë po bënin në auto-larje dhe se si tre të rinj u dukën aty. Dy prej tyre nxorën thika dhe i treti një armë. **K.D.** dhe **N.M.** u larguan me vrap, ndërsa **A.Z.** __ qëndroi prapa. Më pas, njëri nga të rinjtë bëri një gjest fyt-prerjeje, ndërsa tregonte tek dy të tjerët që po largoheshin me vrap. **A.Z.** __ u tregoi shokëve të tij për këtë pas kthimit të tyre në autolarje.

¹³ Lidhja I e Prokurorisë, faqet 242-260.

¹⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafët 515-524, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

79. Gjatë shqyrtimit, tre viktimat identifikuan **V.B.** _____ si njëri prej të rinjve¹⁵. **K.D.** _____ shtoi se ky i mitur ishte ai i cili u kishte drejtuar armën atyre¹⁶, që logjikisht nënkupton se dy të tjerët mbanin thika. Gjatë identifikimit të personave në procedurën paraprake, **A.Z.** _____ identifikoi pozitivisht **V.B.** _____ (n. 4.) dhe **A.P.** _____ (n. 10.)¹⁷; **K.D.** _____ identifikoi **V.B.** _____ (n. 4.) dhe **A.S.** _____ (n. 15.)¹⁸; **N.M.** _____ identifikoi **V.B.** _____ (n. 4.) dhe **A.S.** _____ (n. 15.)¹⁹.

80. Siç u tha më parë, **V.B.** _____ dha deklaratë në gjykatë dhe iu referua deklaratave të tij të mëparshme, që pastaj mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë. Në njërin prej këtyre deklaratave, ai përmendi se shoqërohej nga **A.S.** _____ dhe **M.D.** _____ ndërsa po shkonte për një shëtitje në Mitrovicën e veriut. Ai pranoi kishte nxjerrë një armë. Ai tha se shokët e tij dhe ai u sulmuan nga një grup serbësh²⁰.

81. Gjykata i besoi deklaratat e dëshmitarëve pasi ato vërtetnin njëra-tjetrën dhe u dhanë në mënyrë të sigurtë. Sulmi që i mituri **V.B.** _____ përmendi se kishte pësuar nuk është i besueshëm: **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ kishin vepruar tashmë me dhunë në të kaluarën e afërt për arsye etnike dhe ky incident ishte edhe një më shumë që i shtuan sjelljes së tyre shkatërruese në atë kohë. Nuk ka shpjegim logjik që të miturit të posedojnë armë, përveç vullnetit të tyre për të shkaktuar probleme. Gjithashtu, fakti që **K.D.** _____ dhe **N.M.** _____ menjëherë vrapuan në kërkim të policisë tregon se ata nuk kishin synime agresive. Së fundi, pas ngjarjeve, i mituri **V.B.** _____ dërgoi direkt disa foto me anë të Facebook-ut për **K.D.** _____, foto të cilat kanë qëllime të qarta kërcënuese dhe zbulojnë që me të vërtetë ata ishin sulmuesit dhe i sulmuari²¹.

82. Gjykata u përball edhe një herë me të njëjtën situatë që përcaktoi se cili nga të miturit ishte dhe nuk ishte i pranishëm gjatë atij sulmi. I mituri **V.B.** _____ pranoi që kishte marrë pjesë në incidentin tek auto-larja, ku ai mbante armë dhe ai u identifikua nga viktimat në dy faza të ndryshme të procedurës. Nuk ka asnjë dyshim se ai mori pjesë në këtë ngjarje. Pak më vonë, në të njëjtën ditë dhe aty afër, i mituri **V.B.** _____ u regjistrua duke mbajtur një armë, që vetëm përforcon bindjen e trupit gjykues se ai vringëlli të njëjtën armë në auto-larje.

83. I mituri **A.S.** _____ u identifikua pozitivisht nga dy prej viktimave gjatë një procedure identifikimi, por jo në gjykatë. Gjykata konsideroi se këto identifikime kishin vlera të mjaftueshme provuese për të provuar vetë praninë e tij në vendin e ngjarjes. Një rrethanë tjetër dhe disi më e dobët u shqyrtua. Në një kohë pas incidentit tek auto-larja, i mituri **A.S.** _____ do të regjistrohej jo shumë larg nga ai vend dhe i shoqëruar nga i mituri **V.B.** _____ dhe të tjerë. Kjo provë tregon se në pasditen e ngjarjeve ata ishin të dy së bashku në

¹⁵ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafët 72-79, 242-254, 653-660, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

¹⁶ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafët 250-254, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

¹⁷ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 472.

¹⁸ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 326.

¹⁹ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqe 336.

²⁰ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqet 944-947.

²¹ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqet 466, 467, 468; Shih Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafët 255-284, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

Mitrovicën e veriut. Në posedim të grupit u gjetën një pistoletë dhe disa thika²². Për këtë arsye, Gjykata nuk ka pasur dyshime të arsyeshme lidhur me pjesëmarrjen e të miturit **A.S.** ___ në rastin në fjalë.

84. Kur është fjala për të miturin **M.D.** _____, prova vendimtare për praninë e tij në auto-larje ishte deklarata e të miturit **V.B.** ___. Nenet 123, paragrafi (5), dhe 262, paragrafi (1), të KPP-së, e parandalojnë këtë rezultat. Prania e tij disa herë më vonë në një vend të afërt nuk do të ishte e mjaftueshme për të përfunduar, në vetvete dhe pa dyshime, praninë e tij në auto-larje më herët.

85. Nuk u arrit të përcaktohet se cili nga të miturit bërë gjestin me dorën në fyt.

86. K.D. _____ përshkroi se si ai u kontaktua nëpërmjet Facebook-ut nga **V.B.** _____, i cili më pas i dërgoi atij disa fotot që ai më vonë ua dha autoriteteve, të cilat ua shtuan ato shkresave të lëndës²³. Megjithëse printimi i dytë ka cilësi të dobët, në monitor të kompjuterit të tij K.D. _____ arriti të identifikonte ndërtesën e tij në sfond të **V.B.** _____, i cili vesh një xhakëtë me një emblemë të UÇK-së²⁴. K.D. _____ u ndje i frikësuar nga këto foto, të cilat kanë motive të qarta kërcënuese pas tyre.

87. Sipas raportit të analizës balistike të pistoletës. të bërë më 30 mars 2016, pistoletë e konfiskuar që do të gjendej më vonë në posedim të të miturit **A.P.** _____ kur u kap, ajo është në fakt një pistoletë gazi e kalibrit 9mm. Për më tepër, i njëjti raport deklaroi se pistoletë është riprojektuar për të përdorur plumba të armëve të zjarrit. Gjatë ekzaminimit fizik të armës, u konstatua gjithashtu se arma vetë nuk funksiononte pasi mekanizmi shkrepës dhe gjilpëra janë të dyja jofunksionale²⁵.

E.3.3 Akuza III

88. Lidhur me Akuzën III, Gjykata mendon se është detyra e saj të thotë se është teknikisht e pasaktë të përdoren terma ligjore, sidomos të veprave penale, në një përshkrim faktik ose si mënyrë për të përshkruar veprimet kriminale të të miturve, siç përcaktohet në kërkesën: ‘... *qëllimi për të nxitur tensione ...*’, ‘Ata shkuan në varrezat myslimane dhe *vodhën ...*’ dhe ‘**V.B.** _____ duke mbajtur një pistoletë dhe *duke kërcënuar ...*’.

89. Në lidhje me faktet nën Akuzën III, Gjykata shqyrtoi provat e mëposhtme: deklaratat në gjykatë të të miturve **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____, një deklaratë dëshmitari, një video incizim dhe raportet e policisë.

90. Në lidhje me veprën penale të pretenduar të vjedhjes, të miturit **A.P.** ___ dhe **V.B.** ___ pranuan në deklaratat e tyre se shkuan në varrezat myslimane dhe hoqën disa flamuj

²² Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqet 186-201.

²³ Shih Lidhjen 1 të Prokurorisë, faqet 466-467 and Lidhja I e Prokurorisë, faqet 135-136.

²⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafët 255-279, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

²⁵ Ballistic expert analysis dated 30 mars 2016, Lidhja IV e Gjykatës, Tabela 9.

serbë për shkak se ata i shqetësonin. I mituri **A.P.** ___ do të gjendej më vonë, në kohën e arrestimit nga ana e autoriteteve, në posedim të flamujve.

91. Deklaratat në gjykatë të **A.P.** ___ dhe **V.B.** _ në lidhje me ngjarjet që ndodhën në varrezat, duke qenë prova e vetme që e inkriminon **A.S.** _____, **M.D.** _____ dhe **B.S.** _____, nuk mund të përdoret kundër këtyre të fundit, pasi këtyre tre të miturve nuk iu dha mundësia të kundërshtonin dëshmi të tilla, siç parashikohet në nenin 262, paragrafi (1), të KPP-së.

92. Pranimi i **M.D.** _____ gjatë pyetjes në procedurë paraprake²⁶, kur ai pranoi se kishte marrë flamujt, kësisoj, do të ishte e vetmja provë mbështetëse e fajësisë së tij. Megjithatë, Neni 123, paragrafi (5) i KPP-së, nuk e lejon këtë.

93. Prandaj, prova e vetme në posedim të Gjykatës në lidhje me ngjarjet që ndodhën në varreza është rrëfimi i **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ se ata vodhën flamujt serbë nga varrezat.

94. Nuk u ofrua asnjë provë për të përcaktuar vlerën e flamujve.

95. Në lidhje me pretendimet e Kërcënimit, nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit nacional, racor, fetar ose etnik dhe mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve më 27 maj 2015, një qytetar bëri një video incizim në ditën e ngjarjes²⁷, në të cilën pesë miturit, përkatësisht **A.P.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **B.S.** _____ mund të identifikohen lehtë duke ecur së bashku në Mitrovicën e veriut.

96. Në video incizim, i mituri **V.B.** _____ mund të shihet duke mbajtur një armë dhe buke bërë gjeste me të. Në deklaratat e tij, **V.B.** _ pranoi se mbante armë. Disa momente më vonë, në video mund të shihet edhe persona të tjerë pas të miturve. I mituri **A.P.** _____ duket se mban diçka me shkëlqim në dorë, me siguri një thikë, por lëvizjet e tij të shpejta nuk e lejojnë Gjykatën të jetë e sigurt për këtë.

97. L.J. _____, _____ _ _____, arriti të ndalonte tre nga të miturve pas marrjes së raporteve me radio në lidhje me aktivitetet e tyre. Një raport i policisë i orës 19:30²⁸ jep detaje të sendeve të gjetura në shpinën dhe trupin e të miturit **A.P.** _____. Arma që ishte parë në posedim të **V.B.** _____ në video incizim u gjet në posedim të të miturit **A.P.** _____, kur ai u kap nga policia²⁹. Për shkak të kësaj, gjykata ka prova se të dy të miturit **V.B.** ___ dhe **A.P.** ___ e përdorën armën gjatë incidentit.

98. Për më tepër, gjatë intervistës së tij në Procedurën Paraprake, i mituri **A.P.** _____ deklaroi se e kishte blerë pistoletën nga 'një djalë rom, i cili erdhi nga veriu'³⁰. Ai

²⁶ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 780.

²⁷ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 205.

²⁸ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 105.

²⁹ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 105.

³⁰ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 849.

gjithashtu deklaroi se **V.B.** __, **A.S.** __, **M.D.** __, **B.S.** __ dhe ai vetë vendosën të shkojnë në veri të Mitrovicës me armën, duke specifikuar se arma kishte një mbushës, por ishte pa municion³¹.

99. Raporti balistik i datës 30 mars 2016 dhe i paraqitur nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë e përshkroi pistoletën si E_____ V_____, riprojektimin e saj dhe gjendjen e saj jofunksionale³².

100. Në video incizimin e përmendur më lart, pesë miturit mund të shihet duke u grindur me një grup serbësh të Kosovës në rrugë.

101. Kërkesa Prokurorisë pohon se të miturit ‘pothuajse filluan një përleshje’ me atë grup qytetarësh dhe se **V.B.** _____ ishte ‘duke kërcënuar’ grupin tjetër me armën e tij.

102. Pas një analize të video incizimit, Gjykata konstaton se nuk ka prova që demonstrojnë se miturit ishin nismëtarë të konfrontimit. Videoja tregon një grindje mes dy grupeve dhe se i mituri **V.B.** _____ bënte gjeste me një armë në rrugë. Ai nuk ia drejtoi armën ndonjërit nga grupi tjetër. Meqë videoja ka regjistruar ngjarjet që vazhdonin dhe nuk ka asnjë provë tjetër, nuk është e mundur të dimë saktësisht se çfarë e shkaktoi përplasjen mes dy grupeve.

103. Dëshmia e oficerit të policisë konfirmon se Policia e largoi grupin e të miturve larg grupit tjetër³³. Oficeri i policisë dëshmoi para gjykatës se ai nuk i ka parë të miturit duke bërë gjeste me duar, por duke vrapuar apo ikur³⁴.

E.3.4 Akuzë IV

104. Kur është fjala për Akuzën IV, i mituri **A.P.** ___ i pranoi faktet. Një kopje e postimit Facebook mund të gjenden në faqen 868 të rastit Prokuroria dosjes. Kjo është dëshmi e vetme e paraqitur nga zyra e Prokurorisë për të mbështetur pretendimin e tyre për kryerjen e veprës penale të Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, nga i mituri **A.P.** _____.

105. Nga fotoja e postuar në Facebook, Gjykata njih të miturin **A.P.** _____ po i vë zjarrin me çakmak një flamuri serb. Megjithatë Gjykata vëren se nuk ka mesazh të shkruar që të shoqërojë postimin e fotos. Për më tepër, mund të shihet se vetëm një komentues i menduar i përkatësisë etnike serbe ndërhyr një herë duke shkruar një mesazh në alfabetin cirilik.

106. Një përkthim i pjesshëm i komenteve që pasuan bashkangjitur fotos mund të gjendet në faqen 1565 të Lidhjes IV të Prokurorisë.

³¹ Lidhja I e Prokurorisë, faqe 580.

³² Shih Raporti Balistik i datës 30 mars 2016, Lidhja IV e Gjykatës, Tabela 9.

³³ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafi 774, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

³⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07 mars 2016, paragrafi 802, Lidhja III e Gjykatës, Tabela 16.

F. GJETJET LIGJORE

F.1. Akuza I

107. Të miturit **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____ dhe **B.S.** _____ janë akuzuar me kryerjen e veprës penale të bashkë-kryerjes së vrasjes së rëndë në tentativë, në shkelje të nenit 179, paragrafi (1.10), lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së.

108. Neni 179, Paragrafi (1.10) të KPRK thotë:

(1) Dënimi (...) dënohet personi i cili:

1.10 privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.

109. Bashkëkryerja është përcaktuar në KPRK sipas nenit 31 si më poshtë:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër³⁵ penale.

110. Pjesa e parë e përkufizimit mbulon personat që marrin pjesë në mënyrë aktive në kryerjen e veprës. Kjo mbulon situatën kur personat veprojnë si bashkë-kryes në kryerjen e veprës duke kryer të njëjtat role apo role të ndryshme që plotësojnë elementin aktiv të veprës (*actus reus*). Marrëveshja në mes të kryerësve të përbashkët mund të krijohet gjatë kryerjes së krimit; paramendimi nuk është i nevojshëm.

111. Pjesa e dytë e përkufizimit mbulon personat të cilët kanë bërë akte përgatitore ose mbështetëse që nuk janë elemente aktive apo përdorim i elementeve aktive të veprës penale, por janë kontribute të konsiderueshme që kanë ndikim në zbatimin e planit të përbashkët.

112. Pjesëmarrja aktive dhe kontributi thelbësor janë reciprokisht ekskluzive: të jetë një bashkë-kryesi personi ose merr pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e veprës apo nuk ka, por ndihmon ndjeshëm në kryerjen e saj.

113. Faktet e provuara tregojnë se **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe dy persona të tjerë ka vendosur të gjithë së bashku për të kaluar Mitrovicë urën kryesore, në mënyrë për të sulmuar dhe të dëmtojë qytetarët e përkatësisë etnike serbe. Duke vepruar, ky grup sulmoi tre fëmijë serbë. Katër nga sulmuesit, përfshirë **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____, grushtuan dhe shkelmuan dy nga shënjestrat e tyre. **A.P.** _____ goditi me thikë viktimën e tretë, duke i shkaktuar një lëndim kërcënues për jetën.

114. Siç u tha, paramendimi nuk është kusht për bashkëkryerjen. Marrëveshja e thjeshtë për të kaluar urën, e bërë momentet para ngjarjes, është e mjaftueshme.

³⁵ Për këtë vepër penale.

115. Një bashkëkryerësi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë tij, siç thuhet në nenin 36, paragrafi (1), të KPRK-së. Kjo dispozitë plotëson Nenin 17, paragrafi (1) të KPRK-së, i cili thotë se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës vetëm nëse ai e ka kryer veprën penale me dashje ose nga pakujdesia.

116. Kjo do të thotë se, në qoftë se një kryes i përbashkët devijon nga plani i përbashkët dhe vepron në mënyrë të tepruar për të cilën nuk është rënë dakord nga të tjerët, devijimi nuk mund t'u atribuohet pjesëmarrësve të tjerë. Pjesëmarrësi i cili devijon nga plani mund të shkaktojë një vepër më të rëndë, ndërsa të tjerët do të vazhdojnë të jetë përgjegjës për veprën më pak të rëndë të rënë dakord.

117. Faktet tregojnë se **V.B.** _____ dhe **.S.** _____ vepruan sipas planit të tyre dhe gjithashtu se **A.P.** _____ tejkaloi atë që ishte rënë dakord.

118. Në bazë të nenit 188, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.1) të KPRK-së, lëndimi i lehtë trupor kryhet sa herë që dikush '*i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një (...) pjese të trupit të personit tjetër*'.

119. **A.P.** _____, **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____, duke grushtuar dhe shqelmuar qëllimisht **N.S.** _____, **B.I.** _____ dhe **Z.K.** _____ në disa pjesë të trupit të tyre, kryen veprën penale të lëndimit të lehtë trupor. Meqë ata vepruan pa ndonjë qëllim vdekjeprurës dhe nuk prodhuan ndonjë pasojë vdekjeprurëse, ata nuk janë përgjegjës për ndonjë veprës penale të vrasjes (përfshirimi bëhet për veprimet e **A.P.** _____ ndaj **N.S.** _____).

120. Kërkesa e Prokurorisë i ngarkon të miturit me kryerjen e një, dhe vetëm një, veprës penale. Por njësisht për veprat penale të lëndimit të lehtë trupor dhe të vrasjes duhet të vlerësohet bazuar në vlerën ligjore të mbrojtur. Për shkak se vlerat e mbrojtura janë integriteti fizik dhe jeta e personit, dhe këto vlera janë, vërtet, të natyrës krejtësisht individuale, shkelja e vlerave të tilla krijon subjektin e veprave penale.

121. Prandaj, trupi gjykues për të mitur konsideron se veprimet e **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ përbëjnë tre vepra penale të lëndimit të lehtë trupor. Ata vepruan si grup dhe kontributet faktike nga secili prej tyre për kryerjen e veprës penale u atribuohen të gjithë të tjerëve, pa nevojën për të përcaktuar kryerjen e një veprës të plotë si të tillë nga njëri prej tyre. Megjithatë, megjithëse trupi gjykues është i lirë t'i kualifikojë në mënyrë të ndryshme nga kërkesa e Prokurorisë veprimet e të miturve, ai nuk mund t'u shtojë akuza të tjera akuzave që Prokurori ka vendosur t'i ndjekë penalisht. Kjo është prerogative e tij.

122. Sa për të miturin **A.P.** _____, megjithëse ai kishte rënë dakord fillimisht për një plan që parashikonte vetëm agresionin fizik, ai vendosi të shkojë përtej tij. Ai përdori një thikë për të goditur **N.S.** _____ dhe mund të parashikonte se veprimi i tij mund të kishte pasojë vdekjeprurëse, pasojë që fatmirësisht nuk ndodhën. Pjesa e trupit që ai vuri në shënjestër dhe forca që ai zbatoi, e mjaftueshme për të goditur thellë tre organe, nuk lënë asnjë dyshim për këtë dhe gjithashtu tregojnë se ai i pranoi pasojat.

123. Neni 20, paragrafi (1) i KPRK-së e përcakton tentativën si më poshtë:
Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar...

124. Tentativa nënkupton mungesën e përfundimit të plotë të veprës.

125. Është e qartë se elementet e veprës penale të referuara janë elementet aktive të veprës dhe jo elementet mendore. *Mens rea* e nevojshme për veprën e plotë duhet të përmbushet gjithmonë në mënyrë që të ketë tentativë: nga ana njohëse, dashja e personit duhet të mbulojë të gjitha elementet e veprës penale, duke përfshirë kriteret që rritin dënimin; në anën volitive, personi duhet të ketë shkallën e nevojshme të dashjes së kërkuar nga vepra në fjalë.

126. **A.P.** _____ veproi me dashje eventuale, siç përcaktohet në nenin 21, paragrafi (3), të KPRK-së: ai ishte i vetëdijshëm se vdekja mund të ndodhte si rezultat i aktit të tij dhe ai e pranoi shkaktimin e saj.

127. Krahas kësaj kështu përfshihet faktori rëndues në bazë të nenit 179, paragrafi (1.10) të KPRK-së. I mituri veproi nisur nga paragjykimi kombëtar: ai i zgjodhi shënjestrat e tij bazuar vetëm në kombësinë e tyre dhe të tij; motivimi i tij ishte intoleranca midis dy kombësive kryesore që banojnë në territorin e Kosovës.

128. I mituri **A.P.** _____ kreu gjithashtu në bashkëkryerje me të miturit **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ dy vepra të lëndimit të lehtë trupor ndaj **B.I.** _____ dhe **Z.K.** _____, pasi ky ishte plani i tyre fillestar. Prokuroria nuk e akuzoi **A.P.** _____ me këto vepra dhe për këtë arsye ato nuk do të merren parasysh.

129. Si përfundim, trupi gjykues për të mitur gjeti se veprimet e të miturve **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____ përbënë dhe se ata kryen veprën penale të lëndimit të lehtë trupor në bashkëkryerje, të dënueshme sipas nenit 188, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.1), dhe neni 31 i KPRK-së.

130. Për sa i përket të miturit **A.P.** _____, trupi gjykues për të mitur gjeti se ai kreu veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, të dënueshme sipas nenit 179, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.11) të KPRK-së.

131. Sa për të miturit **M. D.** _____ dhe **E. R.** _____, faktet e provuara nuk tregojnë se ata morën pjesë në ngjarjet. Prandaj ata nuk janë përgjegjës për kryerjen e ndonjë vepre penale.

F.2. Akuza II

132. Të miturit **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe **M. D.** _____ janë ngarkuar me kryerjen në bashkëkryerje të veprës penale të kërcënimit, në kundërshtim me Nenin 185,

paragrafët (1) dhe (4), lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I mituri **V.B.** _____ është akuzuar gjithashtu me kryerjen e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, paragrafi (1), të KPRK-së.

133. Neni 185 i KPRK-së parashikon si më poshtë:

(1) Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet...

(4) Kushdo që kryen vepër penale nga ky nen me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndimi trupor ose dëmtimi i rëndë për shëndetin, dënohet...

134. Më 27 maj 2015, **V.B.** _____, **A.S.** _____ dhe një tjetër i ri shkuan në një auto-larje të ndodhur në Mitrovicën e veriut, ku tre të rinj ishin të pranishëm. Atje, duke treguar një armë dhe thika, të miturit bënë që dy prej të rinjve të largohen me vrap, ndërsa një i tretë mbeti prapa. Përballë këtij, dhe duke treguar tek dy të tjerët, njëri prej të miturve bëri një gjest duke lëvizur dorën e hapur nëpër fytyrën e vet.

135. Kërcënimi përbëhet nga tre elemente themelore: ai është (1) i ardhshëm, (2) lëndues dhe (3) i varur nga vullneti i vepruesit. Lëndimi nuk duhet të jetë i pashmangshëm. Nëse lëndimi i shpallur është i pashmangshëm, ose në qoftë se aktet e ekzekutimit të lëndimit të shpallur kanë filluar, atëherë është kapërcyer një vijë dhe po ndodh tentimi i ndonjë veprë tjetër, lëndimi trupor ose vrasja, është në vazhdim. Ky element i përkohshëm i kërcënimit është ajo që e dallon atë nga dhuna e zakonshme për kaq shumë vepra penale të parapara, të tilla si sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës (neni 121 i KPRK-së), detyrimi (neni 195 i KPRK-së), grabitja (neni 329 i KPRK-së), e kështu me radhë.

136. Subjektivisht, fjalët, aktet apo gjestet duhet të kenë për qëllim të frikësojnë apo të merren seriozisht.

137. Duke bërë një gjest para **A.Z.** _____, që nënkupton prerjen e kokës dhe interpretohet lehtë në atë mënyrë, duke treguar tek të dy të larguarit, duke bërë me shenjë se jeta e tyre nuk do të jetë e sigurt, të miturit kryen veprën penale të kërcënimit të vënë në akuzë, vepër e dënueshme në bazë të nenit 185, paragrafët (1) dhe (4) të KPRK-së.

138. Gjesti është frikësues, sidomos duke pasur parasysh thikat dhe armën që po mbanin të miturit; kanosja e përdorimit të forcës shtyhet sepse shënjestrat po ikin me vrap dhe të pavëmendshme ndaj gjestit; meqenëse u bë përpara një personi tjetër të lidhur me shënjestrat, ekzistonte një pritshmëri e qartë se mesazhi do të arrinte këtë të fundit, siç bëri.

139. Megjithëse identiteti i personit i cili në të vërtetë bëri gjestet nuk dihet, sjellja e të gjithë atyre – duke vringëlluar armët, duke drejtuar armën – kontribuan në peshën e

kërcënimit. Përdorimi i këtyre roleve të ndryshme është kontributi i secilit prej të miturve në kryerjen e veprës penale që, të vëna të gjitha bashkë, e konsumuan atë.

140. Trupi gjykues për të mitur gjithashtu përcaktoi se i mituri **V.B.** _____ kreu veprën penale të ‘mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve’, nga neni 328 paragrafi (2) i KPRK-së, pasi që u përcaktua se ai posedonte një armë për të cilën ai nuk kishte autorizim.

141. Dëshmitari K.D. _____ tha se i mituri **V.B.** _____ ishte i mituri i cili kishte armën. Dëshmitari N.M. _____ tha të njëjtën gjë megjithëse është më pak i sigurt se armën e kishte **V.B.** _____.

142. Posedimi i armës dhe municionit është i paligjshëm në bazë të nenit 374, paragrafi (1) të KPRK-së i cili thotë:

Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet...

143. Ligji i zbatueshëm gjendet në Ligjin për Armët (LA). Çdo shkelje e dispozitave të Ligjit për Armët krijon përgjegjësi për veprat penale nën KPRK-në (sipas nenit 72 të LA-së).

144. Arma E_____ V_____ është një pistoletë me gaz, por ishte transformuar për t’u bërë armë zjarri. Arma nuk është funksionale.

145. Neni 2 nën-paragrafi (1.27) i LA-së përcakton se çfarë është imitim i armëve, domethënë një pajisje që duket si armë, por nuk mund të përdoret si armë zjarri. Trupi gjykues për të mitur pajtohet se ky përkufizim nuk përputhet me përshkrimin e armës së konfiskuar në posedim të të miturit **V.B.** _____ pasi pistoletë në fjalë fillimisht ishte e aftë për të gjuajtur me plumba gazi 9mm dhe më vonë ishte përshtatur për të gjuajtur plumba armësh zjarri.

146. Arma nuk është funksionale. Megjithëse arma është tani jo funksionale, ajo mund të ishte në qoftë se rregullohen elementet që e pengojnë atë të bëjë qitje.

147. Neni 2 nën-paragrafi (1.35) i LA-së jep një përkufizim të asaj që konsiderohet armë zjarri që është bërë përhershëm e papërshtatshme për përdorim (de-aktivizuar), si ‘një armë zjarri e kategorisë B, C dhe D, e cila është bërë përhershëm jofunksionale përmes zbatimit të një procedure teknike në njërin nga pjesët kryesore të armës së zjarrit, dhe që është certifikuar nga organi kompetent’.

148. Trupi gjykues për të mitur gjeti se ky përshkrim nuk i përshtatet armës në fjalë pasi, po të rregullohej si duhet kjo armë mund të përdoret dhe, eventualisht, të vrasë një person. Arma nuk është bërë përhershëm e papërdorshme dhe në çdo rast kjo procedurë duhet vërtetuar nga organi kompetent, që nuk është sërish rasti këtu.

149. Prandaj, sipas nenit 4 të LA-së, arma e konfiskuar në këtë rast është armë zjarri. Si rezultat, posedimi i kësaj lloj pistolete është veprë penale.

150. **V.B.** _____ e mbante armën pa pëlqimin për të blerë armë zjarri ose leje për të poseduar armë zjarri (shih Nenet 2 (1.11), 4 (1.2.1), 5 (1) dhe 20 të LA-së). I mituri e mbante armën në një vend publik. Ai ishte i vetëdijshëm dhe synonte ta bënte këtë. Si i tillë ai plotëson kushtet e dashjes direkte, sipas nenit 21, paragrafi (2) të KPRK-së.

151. Prandaj, trupi gjykues për të mitur gjeti se i mituri **V.B.** _____ kreu veprën penale të posedimit të paautorizuar të armës më 27 maj 2016 në incidentin në auto-larje pasi ai ishte në posedim paligjshëm të pistoletës që është përshkruar si pistoletë gazi e kalibrit 9mm e riprojektuar për përdorimin e plumbave me armë zjarri të kalibrit 6.35x15mm me një krehër bosh.

F.3. Akuza III

152. Të miturit **A.P.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **B.S.** _____ janë akuzuar me kryerjen në bashkëkryerje të veprës penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, në shkelje të nenit 147 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Të gjithë ata akuzohen edhe me veprën penale të bashkë-kryerjes së kërcënimit, në kundërshtim me nenin 185 paragrafët (1) dhe (4) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe vjedhjes, në shkelje të nenit 325 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

153. Në lidhje me akuzën e vjedhjes, në 04 shkurt 2016, Prokuroria sqaroi se të miturit ishin akuzuar për vjedhje, në kundërshtim me nenin 325 paragrafi (2) të KPRK-së.

154. Neni 325 i KPRK-së parashikon:

(1) Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet...

(2) Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet....

155. Të dy miturit **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ shkuan në varreza dhe hoqën flamujt serbë të pranishëm atje. Të miturit **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ morën pronën e personit tjetër me qëllim të përvetësimit në mënyrë të paligjshme të flamujve për veten e tyre.

156. Vlera e sendeve nuk u përcaktua. Meqë ligji parashikon dy dënime të diferencuara për vjedhjen në varësi të vlerës së aseteve të vjedhura, në përputhje me parimin *in dubio pro reu*, Gjykata duhet të marrë parasysh atë më të favorshmin për të miturit.

157. Prandaj, trupi gjykues konstaton se të miturit **A.P.** _____ dhe **V.B.** _____ kryen në bashkëkryerje veprën penale të vjedhjes, në shkelje të nenit 325 paragrafët (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

158. Në lidhje me tre të miturit e tjerë, trupi gjykues për të mitur konstaton se nuk është vërtetuar se të miturit **A.S.** _____, **M.D.** _____ dhe **V.B.** _____ kanë kryer veprën penale të vjedhjes.

159. Neni 147 i KPRK-së parashikon si më poshtë:

(1) *Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet....*

(2) (...)

(3) *Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet....*

(...)

160. *'Nxitja duhet kuptuar si një veprim me të cilin është e mundur të shkaktohet ndjenja e urrejtjes, përçarjes ose armiqësisë, ndërsa përhapja nënkupton veprimin me të cilin është e mundur të rritet një ndjenjë tashmë ekzistuese e urrejtjes, përçarjes ose armiqësisë'.³⁶ Me fjalë të tjera, të nxitësh do të thotë të krijosh një ndjenjë që nuk ishte e pranishme më parë, ndërsa përhapja do të thotë të shpërndash atë ndjenjë në pjesë më të mëdha të publikut.*

161. Prokuroria argumenton se të pesë të miturit, përkatësisht **A.P.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____, **V.B.** _____ dhe **B.S.** _____, kryen në bashkëkryerje veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, kur, në 27 maj 2015, ata 'pothuajse filluan një përleshje me një grup qytetarësh të nacionalitetit serb' dhe se i mituri **V.B.** _____ mbante një pistoletë dhe 'kërcënuese grupin tjetër', ndërsa **A.P.** _____ kishte 'nxjerrë një thikë'.

162. Faktet e provuara tregojnë se, kur po ktheheshin në pjesën jugore të Mitrovicës, **A.P.** _____, **V.B.** _____, **A.S.** _____, **M.D.** _____ dhe **B.S.** _____ pothuajse u përfshinë në konfrontime fizike me një grup qytetarësh të nacionalitetit serb që ishte duke shkuar pas tyre dhe se në një moment të caktuar **V.B.** _____ mbajti në dorë pistoletën E _____ V _____ dhe bëri gjeste me të.

163. Faktet tregojnë vetëm një grindje në mes të dy grupeve të kombësive të ndryshme, ku njëri prej tyre ishte grupi i të miturve. Nuk ka prova që të tregojnë se të miturit kryen vepër penale atje, sidomos atë të nxitjes së urrejtjes me anë të shkaktimit në grupin tjetër të ndjenjës së urrejtjes. Të miturit mund të kenë vepruar në mënyra të panjohura për trupin gjykues që kanë provokuar zemërimin e grupit tjetër, por që nuk është e barabartë

³⁶ Komentari i Nenit të ngjashëm 134 në Kodin Penal të ish-Republikës së Jugosllavisë (FRY) nga Srzentiç Nikola dh Ljubisa Lazareviç (1995, botimi 5).

me nxitjen apo përhapjen e urrejtjes mes dy grupeve të ndryshme etnike. Zemërimi i turmës ishte i drejtuar ndaj të miturve dhe jo ndaj shqiptarëve si të tillë, megjithëse të miturit ishin të përkatësisë etnike shqiptare.

164. Në lidhje me akuzën e kërcënimit, dhe pa marrë parasysh pasaktësinë teknike në përshkrimin e fakteve, duke përdorur emërtimin e veprës³⁷, është thënë më sipër se kërcënimi është një lëndim i ardhshëm që nuk është i pashmangshëm. Është e qartë se të miturit ishin të gatshëm të përfshiheshin në veprime të dhunshme, nëse të dy grupet do të binin në kontakt me njëri-tjetrin.

165. Prandaj, trupi gjykues për të mitur konstaton se të miturit **A.P.** __, **V.B.** __, **A.S.** __, **B.S.** __, **M.D.** __ dhe **E.R.** __ nuk kryen ndonjë veprë penale përveç posedimit të armës që vijon.

166. Gjatë ngjarjeve, i mituri **V.B.** _____ po mbante në rrugë një pistoletë; të njëjtën ai e kishte mbajtur dikur para ose gjatë incidentit në autolarje. Ky i mitur tashmë është gjetur fajtor për veprën penale të mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, veprë e cila është kryer në rrethana shumë të ngushta të kohës dhe vendit dhe me të njëjtën vendosmëri penale. Ai nuk mund të shpallet fajtor për herë të dytë për të njëjtat fakte.

167. I mituri **A.P.** _____, kur u kap, mbante pistoletën në të brendshmet e tij pranë trupit. Provat tregojnë se ai e posedonte armën në atë ditë pa autorizimin e duhur.

168. Meqë arma është e njëjtë me atë të përshkruar dhe analizuar në Akuzën II, trupi gjykues konstaton se i mituri **A.P.** _____ kreu veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve.

F.4. Akuza IV

169. I mituri **A.P.** _____ akuzohet me kryerjen, më 01 qershor 2015, të veprës së dytë penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, në kundërshtim me nenin 147, paragrafët (1) dhe (3) të KPRK-së.

170. Argumenti i Prokurorisë është se i mituri e kreu veprën duke postuar një foto në llogarinë e tij në Facebook, duke shkaktuar në këtë mënyrë disa debate mes dy etnive serbe dhe shqiptare.

171. Trupi gjykues për të mitur e konsideron kërkesën e Prokurorisë të dyshimtë kur bëhet fjalë për përshkrimin e veprës. A u krye vepra me postimin, ose me ‘debatet

³⁷ Një aktakuzë duhet të përmbajë fakte, jo përfundime. Për shembull, nuk është e përshtatshme të përshkruhen veprimet e personit A, i cili grushtoi dhe shqëlmoi personin B, thjesht duke thënë se A i shkaktoi lëndim trupor B-së dhe prandaj kreu veprën penale të lëndimit të lehtë trupor.

agresive' të nxitura³⁸? A nuk kishte pasur debate, ose ato të kishin qenë civile, sikur të ishte kryer vepra?

172. Trupi gjykues për të mitur gjen se nuk është vërtetuar se, duke publikuar një foto të vetes duke djegur një flamur serb në Facebook, i mituri **A.P.** _____ kreu veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik.

173. Fotografia në fjalë tregon se i mituri nuk respekton një simbol kombëtar dhe treguar mendimin e tij dhe mungesën nga ana e tij të mirësjelljes dhe respektit për të tjerët. Megjithatë kjo foto në vetvete nuk tregon se ai dëshiron që të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Ajo është provokuese, por nuk arrin pragun e nxitjes.

174. Në të vërtetë, nxitja është veprimi i provokimit të sjelljes së paligjshme, ose shtyrja e dikujt tjetër që të silllet në mënyrë të paligjshme. Siç u tha më parë, ai është veprimi i shkaktimit të ndjenjës së urrejtjes, përçarjes ose armiqësisë. Në këtë rast, trupi gjykues për të mitur nuk mund të përcaktojë se me aktin e postimit të fotos të tillë në Facebook i mituri **A.P.** _____ po përpiqej të vinte në mendjen e njerëzve të tjerë vullnetin për të bërë diçka të keqe dhe të paligjshme. Gjithashtu nuk ka prova se ai ishte pjesë e një procesi të bindjes së të tjerëve për të kryer një vepër penale. Në fakt, fotografia ishte postuar pa mesazhe bashkëngjitur.

175. Përveç kësaj, komentet pasuese tregojnë se publiku i cili e uroi të miturin tashmë ndante të njëjtën pikëpamje të gabuar që kishte ai. Posti i të miturit nuk shkaktoi as përhapi urrejtje ose mosdurimi sepse mosdurimi tashmë para-ekzistonte dhe nuk u bë më i fortë ose fuqishëm.

176. Në mungesën e ndonjë lloji tjetër elementesh, trupi gjykues për të mitur pranon se i mituri **A.P.** _____ nuk e ka kryer këtë vepër penale.

G. DËNIMI

177. Trupi gjykues për të mitur gjeti se tre të miturit kryen veprat penale, përkatësisht **A.P.** _____, **V.B.** _____ dhe **A.S.** _____. Në të vërtetë, trupi gjykues për të mitur gjeti se të miturit **M.D.** _____, **B.S.** _____ dhe **E.R.** _____ nuk kryen asnjë vepër penale.

178. Trupi gjykues për të mitur gjithashtu shqyrtoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh në përcaktimin e dënimit. Rrethanat lehtësuese janë të ndryshme për secilin nga të miturit, pasi ato bazohen kryesisht në hetimet sociale të bëra për secilin prej tyre, dhe sjelljet e tyre personale, arsimore dhe shoqërore.

179. Pastaj trupi gjykues mori parasysh dispozitën e nenit 37 të KDM-së, që përcakton se për veprat penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm një dënim.

³⁸ Lidhur me fjalën 'nxitje' shih shënimin numër ³⁷.

180. Për sa u përket rrethanave rënduese, trupi gjykues për të mitur gjeti se sulmi i cili ndodhi më 09 prill 2015 ishte veçanërisht i rëndë dhe se ky ishte një sulm shumë frikacak, i kryer nga një grup i armatosur prej pesë personash të cilët i sulmuan tre viktimat në befasi. Përveç kësaj, një tjetër rrethanë rënduese është se të miturit shkuan dy herë në veri të Mitrovicës, në prill dhe më pas në maj 2015, për të kryer veprat penale atje. Veprimet kriminale kishin vetëm motive etnike, që duhet marrë gjithashtu parasysh kur ky faktor nuk është në vetvete një element i veprës.

G.1. I mituri V.B. _____

181. Trupi gjykues për të mitur gjeti se i mituri **V.B.** _____ kreu këto vepra penale:

- Lëndimin e lehtë trupor (Pika I);
- Kërcënimin (Akuza II);
- Posedimin e paautorizuar të armës (Akuza II);
- Vjedhjen (Akuza III).

182. I mituri **V.B.** _____ u lind më 16 gusht 1999, që do të thotë se ai ishte pesëmbëdhjetë (15) vjeç kur u kryen veprat e lartpërmendura penale në prill dhe maj 2015.

183. Sipas KPM-së, për të miturit zbatohen dy lloje dënimesh, përkatësisht të ashtuquajturat ‘masa’ dhe ‘dënime’.

184. Në bazë të nenit 7 paragrafi (3) të KDM-së, ndaj të miturve të cilët nuk kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale mund të shqiptohen vetëm masa.

185. Prandaj, në bazë të kësaj dispozite, ndaj të miturit **V.B.** _____ mund të shqiptohen vetëm masa.

186. Sipas nenit 7 paragrafi (1) të KDM-së, masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve quahen ‘masa të diversitetit’ dhe ‘masa edukative’.

187. Në bazë të nenit 18 të KDM-së, ka shumë lloje masash të diversitetit që mund të merren, të tilla si ndërmjetësimi, kompensimi, ndjekja e shkollës, pranimi i punësimit apo aftësimit, kryerja e punës së papaguar në shërbim të komunitetit, edukimi me rregullat e trafikut dhe këshillimi psikologjik. Krahas këtyre mund të vendosen masa të tjera edukative në pajtim me nenet 19 dhe 20 të KDM-së, me qëllim që të kontribuojnë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, të tilla si vërejtja gjyqësore, dërgimi në qendër disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masa e dërgimit në edukim institucional.

188. Sipas anketës sociale të bërë lidhur me të miturin **V.B.** _____ më 22 dhjetor 2015, trupi gjykues për të mitur thekson se i mituri vjen nga një familje e mirë. Familja e

tij është e vëmendshme për shkollimin e tij dhe e interesuar në lidhje me të. Ai nuk ka munguar në shkollë dhe, në fakt, është nxënës i mirë. Ky raport është shumë i favorshëm për të miturin.

189. Përkundrazi, trupi gjykues e konsideroi qëndrimin e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor jo të mirë. Ai nuk tregoi asnjë keqardhje, as pendim. Në fakt, ishte krejt e kundërta. Ai përmendi edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të 08 marsit 2016 se ‘shkuarja në veri nuk është krim’. Natyrisht nuk është një krim përveç nëse shkon atje për të kryer vepra penale vetë. Për këtë arsye ai është ende kundërshtues dhe kjo në njëfarë mënyre tregon se ai nuk e ka brendësuar peshën e veprimeve të tij.

190. Për më tepër, u përcaktua se i mituri **V.B.** _____ kontaktoi dëshmitarët K.D. _____ nëpërmjet Facebook-ut pasi kreu veprën penale të kërcënimit, të ngritur kundër tij. I mituri **V.B.** _____ bëri një foto të vetes përpara shtëpisë së K.D. _____, që ishte padyshim një kërcënim i qartë.

191. Duke marrë parasysh të gjitha këto, trupi gjykues për të mitur pajtohet se dënimi i shqiptuar kundër tij duhet të jetë i rëndë.

192. Sipas KDM-së, dënimi më i rëndë në lëndën e dhënë është masa institucionale, ku Gjykata mund ta dërgojë të miturin në qendra disiplinore.

193. Megjithatë trupi gjykues për të mitur pajtohet se nuk është e nevojshme që i mituri të largohet nga familja e tij. Gjatë këtyre procedurave u vu re se babai i tij është shumë i shqetësuar për fëmijën e tij. Përveç kësaj, nuk do të ishte e dobishme që i mituri të largohet plotësisht nga mjedisi i tij, veçanërisht pasi ai është duke ndjekur shkollën në mënyrë të rregullt dhe është nxënës i mirë.

194. Ndikimi i bashkëmoshatarëve dhe ksenofobia, së bashku me njëfarë papjekurie, luajtën rol të madh në ngjarjet.

195. Prandaj, trupi gjykues për të mitur pranon të vendosë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, siç është paraparë në nenin 25 të KDM-së. Kjo masë jepet në bazë të neneve 20 paragrafi (3) dhe 25 të KDM-së. Kjo masë shqiptohet ndaj të miturit interesi më i mirë i të cilit nuk kërkon izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe realizohet me një masë afatgjatë që i jep të miturit mundësinë e edukimit, rehabilitimit ose trajtimit.

196. Për këtë arsye, organi i kujdestarisë do të mbikëqyrë të miturin dhe do të kontrolljë veprimet e tij, veçanërisht duke siguruar që i mituri të larguar nga çdo ndikim negativ, veçanërisht duke mos u shoqëruar me ndonjërin prej të miturve të tjerë në këtë lëndë dhe duke mos pasur qasje në Facebook. Për këtë qëllim, i mituri duhet t’i japë autoritetit të kujdestarisë fjalëkalimin e llogarisë së tij në Facebook.

197. Trupi gjykues për të mitur vendos gjithashtu se një komponent i veçantë i ndër-eticitetit brenda masës edukative është i domosdoshëm, me qëllim që i mituri **V.B.**

_____ të edukuar në dritën e veprave penale që ai ka kryer. Prandaj, urdhërohet që autoriteti i kujdestarisë ta regjistrojë të miturin në programe me komponentë ndëretnikë.

198. Në bazë të nenit 20 paragrafi (3) të KDM-së, masa e tillë mund të shqiptohet ndaj të miturit nga tre (3) muaj deri në dy (2) vjet.

199. Në dritën e të gjitha fakteve dhe rrethanave në fjalë, trupi gjykues për të mitur vendos të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe e vendos të miturin **V.B.** _____ nën mbikëqyrjen e shtuar të organit të kujdestarisë për një (1) vit, në pajtim me nenet 20 paragrafi (3) dhe 25 të KDM-së.

G.2. I mituri A.S. _____

200. Trupi gjykues për të mitur gjeti se i mituri **A.S.** _____ kreu këto vepra penale:
- Lëndimin e lehtë trupor (Pika I); dhe
- Kërcënimin (Akuza II).

201. **A.S.** _____ u lind më 03 qershor 1998. Për këtë arsye ai ishte gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç kur u kryen veprat penale të mësipërme.

202. Në bazë të anketimit social të bërë lidhur me të miturin më 14 janar 2016, i mituri **A.S.** _____ është fëmijë i mirë, i cili ndjek shkollën dhe ka nota të mira.

203. Në bazë të nenit 7 të KDM-së, kundër të të miturit **A.S.** _____ mund të caktohen dënime dhe masa, meqenëse ai ishte mbi gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç kur u kryen krimet.

204. Trupi gjykues për të mitur mori parasysht të gjitha faktet dhe rrethanat dhe vendosi të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë ndaj të miturit **A.S.** _____.

205. Ashtu si i mituri **V.B.** _____, Gjykata vendosi që interesi më i mirë i të miturit **A.S.** _____ nuk e kërkon izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe realizohet me një masë afatgjatë që i jep të miturit mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Përsëri u morën parasysht ndikimi i bashkëmoshatarëve, papjekuria dhe ksenofobia e zbuluar nga veprimet e tij.

206. Prandaj, organi i kujdestarisë do të mbikëqyrë të miturin dhe do të kontrollojë veprimet e tij, veçanërisht duke siguruar që i mituri të largohet nga çdo ndikim negativ, veçanërisht duke mos u shoqëruar me ndonjërin prej të miturve të tjerë në këtë lëndë dhe të mos ketë akses në Facebook. Për këtë qëllim i mituri duhet t'i japë organit të kujdestarisë fjalëkalimin e llogarisë së tij në Facebook.

207. Trupi gjykues për të mitur vendos gjithashtu se një komponent i veçantë i ndër-eticitetit brenda masës edukative është i domosdoshëm, me qëllim që i mituri **A.S.**

_____ të edukuar në dritën e veprave penale që ai ka kryer. Prandaj, urdhërohet që autoriteti i kujdestarisë ta regjistrojë të miturin në programe me komponentë ndëretnikë.

208. Në dritën e të gjitha fakteve dhe rrethanave në fjalë, trupi gjykues për të mitur vendos të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe e vendos të miturin **A.S.** _____ nën mbikëqyrjen e shtuar të organit të kujdestarisë për një (10) muaj, në pajtim me nenet 20 paragrafi (3) dhe 25 të KDM-së.

G.3. I mituri A.P. _____

209. Trupi gjykues për të mitur gjeti se i mituri **A.P.** _____ kreu këto vepra penale:
- Vrasjen e rëndë në tentativë (Akuza I);
- Vjedhjen (Akuza III); dhe
- Posedimin e paautorizuar të armës (Akuza III).

210. **A.P.** _____ u lind më 11 shkurt 1999. Për këtë arsye ai ishte më shumë se gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç në kohën e kryerjes së veprave penale.

211. Trupi gjykues për të mitur nuk ka gjetur rrethana lehtësuese në lidhje me të miturin **A.P.** _____.

212. I mituri u vendos në arrest shtëpiak në maj 2015, pas arrestimit të tij nga Policia e Kosovës në veri të Mitrovicës. Megjithëse ai u ndje shumë keq në atë kohë, ai e shkeli masën e arrestit shtëpiak në qershor 2015³⁹ dhe më pas u vu nën masën e paraburgimit për një kohëzgjatje prej një (1) muaji e pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

213. Gjykata gjithashtu gjeti se kur kreu fillimisht veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë më 09 prill 2015, i mituri **A.P.** _____ ishte nën masën e arrestit shtëpiak në një lëndë tjetër⁴⁰.

214. Krahas kësaj, trupi gjykues për të mitur nuk e vlerësoi të mirë sjelljen e tij në Gjykatë. Më 08 mars 2016, ai nuk i kërkoi falje viktimës N.M. _____.

215. Për më tepër, veprat penale që ai kreu janë jashtëzakonisht të rënda.

216. Në bazë të anketave të shumta sociale të bëra lidhur me të miturin **A.P.** _____⁴¹, është e qartë se i mituri ndaloi ndjekjen e shkollës. Niveli i tij i socializimit nuk po shkon mirë.

³⁹ Lidhja I e Prokurorisë, faqet 1138-1143; Njoftim i Policisë së Kosovës, datë 18 qershor 2015, Dosja I e Paraburgimit e Gjykatës për **A.P.** _____, Tabela 12.

⁴⁰ Lidhja I e Prokurorisë, faqet 1128-1137.

⁴¹ Raport i anketimit social, datë 29 maj 2015, Dosja I e Paraburgimit e Gjykatës për **A.P.** _____, Tabela 9; Pyetësori Social, datë 19 qershor 2015, Dosja I e Paraburgimit e Gjykatës për **A.P.** _____, Tabela 21; Anketimi Social, datë 15 janar 2016, Lidhja II e Gjykatës, Tabela 10.

217. Në bazë të nenit 7 të KDM-së, kundër tij mund të vendosen masa dhe dënime, meqenëse ai kishte arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16), kur i kreu veprat penale.

218. Gjykata gjithashtu shikoi nëse kishte pasur dënime në të shkuarën, por sipas të dhënave kriminale, i mituri **A.P.** _____ nuk ka dënime të mëparshme. Kjo do të jetë masa e parë që do të caktohet kundër tij.

219. Në dritën e të gjitha fakteve dhe rrethanave në fjalë, trupi gjykues për të mitur pajtohet të caktojë ndaj të miturit **A.P.** _____ dërgimin në institucione edukative dhe në një institucion edukativ korrektues. Trupi gjykues vlerësoi se mituri në mënyrë të qartë duhet të largohet nga familja dhe mjedisi i tij.

220. Neni 28 i KDM-së parashikon se kur një i mitur kryen veprë penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet, sic është rasti këtu, pasi ai ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, Gjykata shqipton masën e dërgimit në institucion edukativ korrektues. Masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

221. Përveç kësaj, kur vendosi lidhur me shqiptimin e masës, Gjykata mori parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale dhe nëse i mituri ka qenë më parë i dënuar. Trupi gjykues për të mitur gjithashtu mori parasysh se i mituri ishte dërguar tashmë në paraburgim në Qendrën e të Miturve në Lipjan për një (1) muaj e pesëmbëdhjetë (15) ditë. Trupi gjykues gjen se është më mirë që ai të dërgohet në një institucion edukativ korrektues.

222. Sipas nenit 28 paragrafi (3) të KDM-së, masa nuk mund të jetë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

223. Meqë një (1) vit është minimumi dhe në dritën e fakteve dhe rrethanave në fjalë, trupi gjykues për të mitur vendos të shqiptojë masën edukative institucionale për dy (2) vjet, sipas neneve 20 paragrafi (4) dhe 28 të KDM-së.

H. KONFISKIMI

224. Trupi gjykues për të mitur vendosi të konfiskojë pistoletën E_____V_____ ref EVL-_____, me krehërin e saj, në bazë të nenit 374 paragrafi (3) të KPRK-së.

I. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

225. Shpenzimet e procedurës do të paguhen nga buxheti i Kosovës, në bazë të nenit 75 paragrafi (1) të KDM-së.

J. KËRKESA PASURORO JURIDIKE

226. Meqë janë caktuar vetëm masa dhe jo dënime, palët e dëmtuara udhëzohen ta realizojnë kërkesën e tyre pasuroro juridike në kontest civil, në bazë të nenit 75 paragrafi (1) të KDM-së.

Gjykata Themelore e Mitrovicës

Nuno Madureira
Kryetar i trupit gjykues

Kimete Fejza

Anëtare e trupit gjykues

Novak Mirkovic

Anëtar i trupit gjykues

Vera Manuello
Proces-mbajtëse

Mjet ligjor:

Personat e autorizuar kanë të drejtë të ankohen kundër këtij Aktvendimi brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e dorëzimit tek palët të këtij Aktvendimi (Neni 77 i KDM-së).